



MINISTRIA E BUJQËSISË,  
ZHVILLIMIT RURAL DHE  
ADMINISTRIMIT TË  
UJËRAVE

QËNDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORE

**RAPORT VJETOR I PROGRAMIT**

*“Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor “*

**VITI 2013**

Drejtoreshë e Drejtorisë së Teknologjive

Athina LLAMBRO

TITULLARI

Aulona VEIZI

Permbajtja

Hyrje

- I **Projekti 1. Teknologji bashkëkohore në pentari**
- A Teknologji dhe teknika në prodhimin e materialit bimor.
- 1 Përcaktimi i moshës më optimale të copave të ullirit për rrënjëzim
- 2 Përcaktimi i afateve optimale të mbjelljes së copave për rrënjëzim në banko. Përçindja e rrënjëzimit në disa kultivarë autoktonë ulliri.
- 3 Prodhimi i fidanave të ullirit me nebulizim duke përdorur raporte të ndryshme substrati ushqimor në qeskat e rritjes
- 4 Ndikimi i përdorimit të ambalazheve të dimensioneve të ndryshme në rritjen dhe zhvillimin e fidanave të ullirit.
- 5 Prova të plehimit gjethor në fidanat e ullirit me nebulizim.
- B Zbatimi i teknologjive në blloqet intensive (pemë, ulli, agrume).
- 1 *Menaxhimi i kurorës në ullishtet intensive dhe superintensive.*
- 2 Aplikimi i teknologjisë më optimale (menaxhimi i tokës, kurorës, parazitëve etj.) në resurset gjenetike (ullishte, pemë frutore, vreshta).
3. Modele tekniko- ekonomike të ullishteve
- C Përgatitja e specialistëve dhe fermerëve nga ana teoriko-praktike me koncepte të reja për menaxhimin e kulturave drufrutore.
- 1 Seminare kombetare
- 2 Demonstrime
- 3 Dite fushe
- 4 Trajnime të hapura
- 5 Biseda ne television.
- D Projekte te kërkimit në fermë
- 1 Rikonstruksioni i ullishteve
- 2 Krasitja prodhuese në ulli
- 3 Monitorimi dhe luftimi i mizës mesdhetare në agrume.
- 4 Teknika të mbrojtjes nga miza e ullirit në cv. Kokërr Madh Berati
- II **Projekti 2. Menaxhimi i resurseve gjenetike (pemë frutore, hardhi, ulli dhe agrume) dhe shtimi i materialit bimor**
- A Eksplorimi dhe grumbullimi resurseve gjenetike në pemë frutore (qershi, kumbull, dardhë, shegë, fiq etj), ulli e hardhi
- B Pasurimi i koleksioneve me kultivarë të tjerë autoktonë
- 1 Mbjellja e aksesioneve të kumbullës, dardhës dhe fikut në koleksionin e pemëve frutore autoktone
- 2 Promovimi i verërave dhe vajit të ullirit me kultivarë autokton
- C Studimi i specieve kumbull e dardhë në koleksionin e pemëve frutore autoktone
- D Kontrolli i materialit bimor
- 1 Hartimi i protokolleve të trajtimeve për ullishtet mëmë
- 2 Zbatimi i teknologjive në pemtore, ullishta e vreshta
- 3 Testimi i kultivareve autokton sipas CPOV
- 4 Zbatimi i teknologjive në koleksione dhe parcela mëmë (pemë frutore, ulli e hardhi)
- 5 Çertifikimi i materialit bimor të ullirit.

- III **Projektit 3 . Studim, Projektim dhe Modelim fermë në pentari**
- A Studim 1 “Sisteme të ullishtarisë me efektivitet të kufizuar. Aspekte tekniko-ekonomike të menaxhimit“.
- B Studimi 2: “Planifikimi dhe ndjekja e kostove të prodhimit në pentari”
- C Bashkepunimi me institucionet
- D Projekte me institucione te huaja
- E Bazat e teknologjive te komunikimit dhe informacionit
- F Menaxhuesit e projekteve

## Hyrje

Në vitin 2013 aktivitetet u fokusuan në:

a) Përmirësimin e teknologjive, përmirësim të kërkimit në ferme dhe transferimit të teknologjive në më shumë fermerë; b) në resurset gjenetike; c) studime ekonomike.

Ka një rritje sasore dhe cilësore të elementeve të transferimit të teknologjise bujqësore dhe në vecanti të ditëve të fushës për demonstrime, seminare kombëtare dhe ndërkombetare për probleme që kanë të bëjnë me cilësinë e produkteve dhe përdorimin efikas të inputeve bujqësore.

MBUMK në vitin 2013 financon nëpërmjet dy programeve të rëndësishme: “ Këshillimi dhe informacioni bujqësor ” dhe “Zhvillimi rural duke mbeshtetur prodhimin bujqësor e blegtoral, agroindustrinë dhe marketingun”.

Në vitin 2013 aktivitetet janë zhvilluar të ndarë në tre projekte

Eshtë rritur bashkëpunimi me institucione të vendit si projekti AAC-USAID, UBT, Instituti i Bujqesise Biologjike, me institucione te huaja si CNR Itali ,USAID, Perialisi, CNR-IVALSA,.

Aktivitetet programit te MBUMK : “*Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor* “ ndahen ne tre projekte:

**I. Projekti 1. “Teknologji bashkëkohore në pemëtari”.**

**Objektivi 1. Teknologji dhe teknika në prodhimin e materialit bimor të ullirit.**

**1. Përcaktimi i moshës më optimale të copave të ullirit për rrënjëzim**

Shtimi i ullirit me copa me anë të nebulizimit është një metodë që në Shqipëri po përdoret që nga viti 1988-1989 në Institutin e Pemetarisë sot Q.T.T.B Vlorë. Me prioritetin që i është dhënë kulturës së ullirit ku sipërfaqet e mbjella po rriten nga viti në vitë prodhimi i fidanëve po mer një rëndësi të madhe dhe Qendra jonë luan një rol të madh pasi prodhon çdo vit mbi 100.000 fidanë me nebulizim. Copat e gjelbra që përdoren për shtimin e ullirit me nebulizim përgatiten nga degëza e rritjes së vitit. Degëzat rrjedhin prej fluksit të parë të rritjes vegetative ose të fluksit të fundit por që nuk e kalojnë moshën një vjeçare, janë degëza nga 3-12 muaj. Nga çdo degëz fitohen tre tipe copa të gjelbra: Copa e bazës, copa e mesit dhe copa e majës së degëzes. Duke u nisur nga këto karakteristika me anë të këtij studimi pamë ndryshimin në % e rrënjëzimit në kalemata e marrë nga fluksi i parë i rritjes vegetative dhe nga fluksi i fundit i rritjes vegetative (pranverë dhe vjeshtë).

Vendi i ngritjes së eksperimentit: Sera e shumëzimit Shamogjil.

Data e mbjelljes 09.04.2013

**Treguesit** që u morën:

- Numri i bimëve të rrënjëzuara (% e rrënjëzimit)
- Numri i rrënjëve.
- Gjatësia e rrënjëve

**Metodika** e përdorur:

Për të realizuar këtëstudim u bënë dy prova:

- Prova 1 - Rrënjëzimi me copa të marra nga kalemata e pranverës
- Prova 2 - Rrënjëzimi me copa të marra nga kalemata e vjeshtës

Për çdo provë u vunë për rrënjëzim nga 1000 kalema me kultivarin “Kalinjot”

U përdor teknologjia standarte e prodhimit të fidanëve me nebulizim.

Përqindja e rrënjëzimit rezultoi si më poshte:

**Tab.1**

Provat	Nr.kalemave të mbjellë	Nr.kalemave të rrënjëzuar	% e rrënjëzimit
p1	1000	380	38
p2	1000	395	39.5

Numri i rrënjëve dhe gjatësia e tyre paraqiten në tabelën më poshtë:

Tab. 2

Provat	Nr. mesatar i rrënjëve	Gjatësia mesatare e rrënjëve
P1	5.3	5.6
P2	6	6.2

Për të nxjerrë mesataren u numëruan nga 50 kalema për çdo provë.

**Konkluzione dhe rekomandime.**

Rezultatet e mësipërme tregojnë që kalemata e marrë nga rritja e vjeshtës që korrespondon dhe me pjesën e mesit të lastarit një vjeçar ka përqindje më të lartë rrënjëzimi me një diferencë prej 1.5% me shumë dhe zhvillim më të mirë të sistemit rrenjor. Megjithatë këto difereca janë në nivelet për të mos u marrë në konsiderat. Konkluzioni është se kalemata e marrë nga lastarë 1 vjeçarë pavarësisht nga pozicioni i tyre, në bazë, mes apo majë janë vitalë, me aftësi rrënjëzuese të lartë dhe të vetmit për shtimin e ullirit me nebulizim.

**2. Përcaktimi i afateve optimale të mbjelljes së copave për rrënjëzim në banko. Përqindja e rrënjëzimit në disa kultivarë autoktonë ulliri.**

**Rezultati 2:** Përcaktimi i afateve optimalë i mbjelljes së copave për rrënjëzim në banko. Prova të % së rrënjëzimit në cv.autokton”.

**Rëndësia dhe qëllimi:** Aftësia rrënjëzuese e copave të ullirit me nebulizim është mjaft variable dhe varet nga shumë faktor ndërmjet të cilëve afati i mbjelljes dhe kultivari. Nga viti në vit po shtohen sipërfaqet e mbjella me ulli jo vetëm në kodër por edhe në zonat fushore pra, kërkesat e fermerëve për fidanë janë në rritje. Duke patur parasysh këtë faktë del e domosdoshme mbjellja e serrës më shumë se një herë në vitë, si pasoj dhe përcaktimi i afateve të tjera optimal, për të rritur numrin e fidanëve dhe për t’u përgjigjur kërkesave të fermerëve veçanërisht me kultivarë auokton.

**Vendi i ngritjes** së eksperimentit: Serra Shamogjil

**Treguesit** që u morën: % e rrënjëzimit, numri i rrënjëve, gjatësia e rrënjëve.

**Metodika** e përdorur: Studimi për përcaktimin e afateve optimalë të mbjelljes së copave për rrënjëzim u bë edhe gjatë vitit 2012 në muajt Mars dhe Tetor dhe u morën keto rezultate:

Afati i mbjelljes	% e rrënjëzimit	Numri mesatar irrënjëve	Gjatësia mesatare e rrënjëve
Mars	38.4	5.6	7.2
Tetor	20	5.2	6.3

Siç shihet edhe nga tabela rrënjëzimi i muajit tetor rezultoi i dobët krahasuar me rrënjëzimin e pranverës, ndërsa zhvillimi i sistemit rrenjor nuk pati ndryshime të dukshme që bëjnë diferencën. Për arsye objektive vitn e kaluar nuk u realizua mbjellja në afatet e tjera të parashikuara në metodikë prandaj ky studim vazhdoi edhe gjatë vitit 2013, ku përveç afatit të pranverës pra

mbjelljes së muajit mars u bën prova rrënjëzimi edhe në periudha të tjera kohore dhe konkretisht në muajin gusht dhe shtator.

**P1** - Mbjellja në muajin Mars

**P2** - Mbjellja në muajin Gusht

**P3** - Mbjellja në muajin Shtator

Treguesit që u morën:

-% e rrënjëzimit

-Numri i rrënjëve

-Gjatësia e rrënjëve

Në të tre provat u rrënjëzua i njëjti kultivar “Kalinjot”.

**P1.** Afati i muajit **Mars**. Eksperimenti u mboll në datë 30.03 dhe u shkull në 28 .05. U bën disa sondazhe dhe për mbjelljet e muajit mars përqindja e rrënjëzimit rezultoi 33%. Përsa i përket dy treguesve të tjerë numrit të rrënjëve dhe gjatësisë së tyre matjet u bën për 50 bimë dhe rezultoi:

Numri mesatar i rrënjëve 5.4 rrënjë

Gjaësia mesatare 7.4cm

**P2.** Mbjellja u bë në datë **1 gusht**.

Në bankon e rrënjëzimit në të cilën u mboll eksperimenti u bë ndërhyrje në sistemin e shihedhjes duke shtuar numrin e sprucatorëve dhe lartësin e tyre deri në 70 cm. Kalemata qëndruan për rrënjëzim tej afatit teknologjik 45-60 ditë por 120 ditë deri në datë 5 dhjetor. Nga numërimi doli % e lartë rrënjëzimi deri në 45%. Zhvillimi i sistemit rrënjor (numri i rrënjëve dhe gjatësia e tyre) ishte normal, pa diferenca nga ai i muajit mars.

**P3 .** Mbjellja u bë në datë **3 shtator**.

U mbajt i njëjti rregjim si ai i muajit Gusht. Shkulja u bë në fillim të muajit dhjetor.

Nga 500 kalema të numëruara ishin të rrënjëzuar 148 ose 29.6%

Provat	Nr. kalemave të mbjellë	Nr.kalemave të rrënjëzuar	% e rrënjëzimit
Mars	500	165	33
Gusht	500	245	45
Shtator	500	148	29.6

**Konkluzione:** Për muajin Mars pra afatin e pranverës vazhdimisht janë bërë prova në vite dhe është vërtetuar që është afati më optimal i mbjelljes së copave për rrënjëzim në banko. Studimi i këtij viti tregoi për % të lartë rrënjëzimi në muajin gusht gjë që nuk është eksperimentuar më parë, pasi janë kryer prova për periudhën 15 shtator dhe gjatë muajit tetor. Rrënjëzimi i muajit shtator edhe këtë vit është brenda pritshmërive krahasuar me rezultatet e viteve të kaluara.

Ky studim tregoi që mbjellja e serës në muajin gusht është e suksesshme dhe e

**rekomandueshme** sepse:

1. Ka % të lartë rrënjëzimi
2. Ka kosto të ulët prodhimi pasi eliminohet ngrohja.

**Prova të % të rrënjëzimit të cv. Autokton**

Prova të rrënjëzimit të kultivarëve autokton u kryen edhe gjatë vitit 2012 dhe një pjesë e mirë e tyre u përsërit edhe këtë vit.

Në muajin Mars krahas kultivarit “Kalinjot”, u rrënjëzuan në bango edhe kultivarë të tjerë autokton pasi vitet e fundit po merr prioritet shtimi i sipërfaqeve të mbjella me keto kultivarë. Më poshtë jepet një pasqyrë për % e rrënjëzimit të çdo njërit prej tyre.

K.M.B	4%	Kallmet	28%
Mixan	63%	K.M.E	45%
Kotruvsi	20%	Kalinjot Pobrat	29%
Kushan	83%	Vajsi Peqin	28%
U.B.Pobrat	16%	Karen	16%
Frëngu Krujë	45%	Krypsi Krujë	85%
Boci	12%	Managjel	22%
Unafka	5%	U.B.Krujë	35%
Nisiot	74%	Ulliri Zi	20%
Ulliri Kuq	52%	U.B.Tiranë	71%

Siç shihet kultivarë të vendit me rrënjëzim të mirë dhe shumë të mirë janë Mixan, Kushan, K.M.E, Frëngu I Krujës, Nisiot, Ulliri Kuq, Krypsi Krujës, U.B.Krujë, U.B.Tiranë.

Përsa i përket kultivarit K.M.B nga prova e dy viteve por edhe nga ato të viteve të tjera arrijmë në përfundimin se ky kultivarë nuk jep rezultat në rrënjëzimin me copa me anë të nebulizimit.

### ***3. Prodhimi i fidanave të ullirit me nebulizim duke përdorur raporte të ndryshme substrati ushqimor në qeskat e rritjes.***

**Rezultati 3.** Prodhimi i fidanëve të ullirit me nebulizim duke përdorur raporte të ndryshme substrati ushqimor në qeskë.

**Rëndësia dhe Qëllimi** i përdorimit të substrateve të ndryshëm.

Prodhimi i fidanëve të ullirit është tani prioritet i Q.T.T.B-së. Me ndërtimin e serrës me nebulizim me kapacitet prodhues rreth 200000 fidanë në vit është e rëndësishme të përcaktojmë substratin më të mirë mbjellës për trapiantimin e fidanëve pas ambjentimit deri në shitje. Ekziston një numër i madh kërkimesh dhe eksperiencash dhe një literaturë e pasur në lidhje me këte problem por është detyra jonë që nëpërmjet zbatimit në praktikë të rezultateve të arritura të realizojmë provat tona për të gjetur kombinimet më të mira për kushtet zonale duke dhënë në këtë mënyrë një kontribut në zhvillimin e fidanishteve të zonës. Veçoria e zonës sonë është përmirësimi i teknologjisë pasi deri më sot substrati përbëhet kryesisht nga materiali inert që merret në aluvionet e lumit Vjosë por që ka krijuar probleme në sigurimin e ajrimit të sistemit rrënjor dhe të zhvillimit të mirë me kalimin e kohës.

Eshtë e nevojshme që substrati i kontenitorëve të sigurojë një ambjent të mirë për rritjen dhe ushqimin e fidanëve për kohën e qëndrimit në fidanishte. Duke qënë se volumi i tij është i kufizuar merr një rëndësi të madhe zgjedhja e materialit më të mirë duke synuar në uljen e kostos brënda kufijve që lejojnë sigurimi i parametrave optimal.

Për këtë qëllim del e domosdoshme përcaktimi i raporteve më të mira të dheut, torfës, plehut organik, materialit inert dhe plehut kimik të tilla që të sigurojnë substratin më të përshtatshëm për zhvillimin normal të bimës dhe me kosto me të ulët. Ai duhet të jetë i përshkueshëm me qëllim ajrosjen e sistemit rrënjor, i pastër nga nematodat dhe dëmtues të ndryshëm.

Vendi i ngritjes së studimit: Serra Shamogjil.

Treguesit që u morën: Janë tregues të rritjes dhe zhvillimit të bimës si:



1. Diametri i trungut
2. Lartësia e bimës

**Metodika e përdorur:**

Ky eksperiment vazhdon nga viti i kaluar ku u morën në provë 8 substrate të ndryshme nga të cilat 4 rezultuan më të mirë dhe konkretisht:

- P6. 80% shtufë + 20% pleh organik
- P7. 80% dhe +20% pleh organik
- P2. 40% dhe +40% shtufë+20% pleh organik
- P3. 50% dhe +25% rërë+ 12.5% torfë +12.5% pleh organik

Siç shihet të katër substratet e më sipërm kanë në përbërjen e tyre pleh organik dhe nga studimi i vitit të kaluar doli si konkluzion që substratet më të mira janë ato që në përbërjen e tyre kanë pleh organik.

Nga matjet dhe vëzhgimi i ecurisë së këtyre fidanëve në fund të këtij viti rezulton që fidanët e rritur në këto substrate pra P2, P3, P6, P7, janë me zhvillim të bujshëm dhe më cilësorë.

Në kushtet kur mungojnë ndërmarrjet e grumbullimit dhe përpunimit të plehut organik është e vështirë të sigurohen sasira të mëdha që të përballohet prodhimi i mbi 150000 fidanëve prandaj ky eksperiment po vazhdon duke përdorur të tjera substrate me material që është i lehtë për t'u siguruar dhe duke e kombinuar me plehra kimik.


Substratin më të mirë të vitit të kaluar P1- 80% shtufë + 20% pleh organik, e ripërsëritëm edhe këtë vit dhe do të shërbej si referim për tre substratet e tjerë të cilat do të përmirsohen si më poshtë:

- P2- 50% shtufë +50% dhe+5 gr/liter NPK
- P3- 50% dhe+ 25% rërë+25% torfë+ NPK
- P4 - 70% dhe +30% shtufë+ NPK

Ndryshimi konsiston në zëvendësimin e plehut organik me torfë dhe pleh kimik me tretje të ngadalshme.

Për cdo provë u mbollën nga 100 bimë duke respektuar kushtet e mëposhteme:

- U mbollë i njëjti kultivarë - "Kalinjot"
- Mbjellja u bë në një ditë datë 02.09.2013
- Filizat ishin me zhvillim gati të barabart
- Madhësia e qeskës e njëjtë
- Shërbimet e mëvonshme si vaditje, spërkatje, plehrime etj., janë të njëjta për të gjitha provat.



**Foto nr. 1, 2.** Momenti i përgatitjes së substrateve dhe mbjellja

Prova	P1	P2	P3	P4
Diametri/mm	4.5	4.1	4.5	4.2
Lartësia/cm	31.8	32.4	25.7	26.6

Matja

e

diametrit dhe lartësisë së bimëve u kryen për 50 bimë në momentin e mbjelljes datë 2 shtator dhe e dyta në datë 10 dhjetor për të parë rritjen reale të bimëve. (Rezultatet janë mesatare e 50 bimëve të matura)

Rezultatet e diametrit dhe lartësisë së bimëve në momentin e mbjelljes datë 1 **shtator** paraqiten në tabelën 1:

**Tabela 1. (Shtator)**

Provat	P1	P2	P3	P4
Diametri/mm	3.9	3.7	3.4	3.4
Lartësia/cm	16.9	19.5	13.1	15.4

**Tabela 2. (Dhjetor)**


Rezultatet e treguesve të rritjes të dala nga matjet e datës **10 dhjetor**.

Rritja e **diametrit** dhe e **lartësisë** si 3-mujor sipas provave.( mm)

**Tabela 3.**

Përmbledhëse e treguesve të rritjes (diametër dhe lartësi) sipas provave:

Prova	P1	P2	P3	P4
Rritje diametrit/mm	0.6	0.4	1.1	0.8
Rritje lartësis/cm	14.9	12.9	12.6	11.2



**Foto nr.3.** Rritja e diametrit dhe lartësisë sipas provave

**Konkluzione dhe rekomandime:**

Siç shihet nga tabela edhe këtë vit substrati më i mirë është 80% shtufë + 20% pleh organik. Me zhvillim të mirë janë edhe bimët e mbjella në substratin 50% dhe +25% rërë+25% torfe+NPK,prova 3 ku ka dhe një rritje më të madhe të diametrit të fidanit .

**4. Ndikimi i përdorimit të ambalazheve të dimensioneve të ndryshme në rritjen dhe zhvillimin e fidanave të ullirit.**

**Rëndësia** e përdorimit të ambalazheve me dimensione të ndryshme.

Një nga detyrat kryesore të Q.T.T.B-së, është prodhimi i fidanëve të ullirit me nebulizim ku çdo vit do prodhohen rreth 200000 mijë fidanë ulliri për krijimin e ullishteve të reja prioritet ky i Qeverisë Shqiptare..

**Qëllimi** i këtij studimi është: Të përcaktoj madhësinë optimale të qeskës (volumin e substratit) e cila siguron zhvillimin normal të fidanit pas trapiantimit deri në marrjen e fidanit standart për shitje dhe me **kosto** sa më të ulët .

Vendi i ngritjes së studimit - Shamogjin.

**Metodika** që do të përdoret:

Studimi u ngrit në **tre** prova:


**Prova 1:** Trapiantimi në qeska 2.5 litër.

**Prova 2:** Trapiantimi në qeska 3.5 litër.

**Prova 3:** Trapiantimi në qeska 5 litër.



Matje Mars 2012



Matje Dhjetor 2013

Për çdo provë u trapiantuan nga 50 bimë.

Gjithsej 150 bimë për trapiantim.

**Treguesit** që u morën në studim gjatë vitit 2013:

1. **Lartësia** e bimës
2. **Diametri** i trungut

Matjet u kryhen në dy periudha:

- Pas trapiantimit të fidanit (Korrik).
- Në fund të vitit (Dhjetor).

Në të tre provat u zbatua e njëjta **teknologji** por, ndryshon vetëm madhësia e qeskës në mënyrë që të dalë efekti real që ka volumi i substratit në rritjen dhe zhvillimin e fidanit dhe konkretisht:

- Mbjellja u krye në të njëjtën ditë për të 3 provat (25 korrik).
- U përdor i njëjti substrat mbjellës.
- Bimët që u trapiantuan janë me zhvillim të barabartë.
- U mboll i njëjti kultivar. (Kalinjot)
- U kryen të njëjtat shërbimet pas mbjelljes si ujitje, spërkatje, plehrime plotësuese etj..

### Rezultatet e arritura:

Tabela 1: Përqindja e zënies së filizave në qeska.

Periudha	Provat		
	Prova 1 (2.5 l.)	Prova 2 (3.5l.)	Prova 3 (5 l.)
Viti 2012	100	100	100
Viti 2013	100	100	100

Tabela 2: Rritja e fidanit (Lartësia).

Periudha	Lartësia mesatare për 1 bimë (cm).		
	Prova 1	Prova 2	Prova 3
Mars 2012	15.9	15.3	15.7
Dhjetor 2012	22	21.8	30.8
Dhjetor 2013	79	83	121

Nga momenti i mbjelljes deri në fund të viti të II-të me rritjen mesatare më të mirë rezulton prova me ambalazh 5 litër (121 cm) krahasuar me dy provat e tjera.

Tabela 3: Ecuria e rritjes së fidanit në vite (lartësia) në cm.

Periudha	Rritja e lartësisë së fidanit (cm).					
	Prova 1		Prova 2		Prova 3	
	cm	Në %	cm	Në %	cm	Në %
Mars-Dhjetor 2012	6.1	38	6.5	42	15.1	96
Dhjetor 2012 - Dhjetor 2013	57	359	61.2	281	90.2	293
Mars 2012 - Dhjetor 2013	63.1	397	67.7	442	105.3	670

Nga të dhënat rezulton se: Ecuria më e madhe e rritjes për të tre provat gjatë periudhës 1 vjeçare të vitit të II-të, Dhjetor 2012- Dhjetor 2013 prova 3 me 670 % krahasuar me provën e I –rë me 397 % dhe provën e II-të me 442 %.

Diferenca për ecurin e rritjes për provën e III-të ndaj dy provave të tjera është e dukshme dhe në tabelë

Tabela 4: Rritja e fidanit (Diametri i trungut).

Periudha	Diametri mesatar i trungut për 1 bimë (mm).		
	Prova 1	Prova 2	Prova 3
Mars 2012	3.3	3.2	3.3
Dhjetor 2012	3.9	3.8	4
Dhjetor 2013	5	5	7

Nga momenti i mbjelljes deri në fund të viti të II-të me rritjen mesatare më të mirë të diametrit të trungut rezulton prova me ambalazh 5 litër (7mm), krahasuar rritja me dy provat e tjera të cilat janë me të njëjtën rritje (5 mm).

Tabela 5: Ecuria e diametrit të trungut të fidanit në vite.

Periudha	Ecuria e rritjes së diametrit të trungut të fidanit (mm).					
	Prova 1		Prova 2		Prova 3	
	mm	Në %	mm	Në %	mm	Në %
Mars-dhjetor 2012	0.6	18	0.6	19	0.7	21
Dhjetor 2012- Dhjetor 2013	1.1	28	1.2	32	3	75
Mars 2012-Dhjetor 2013	1.7	52	1.8	56	3.7	112

Nga të dhënat rezulton se: Ecuria më e madhe e rritjes së diametrit të trungut për të tre provat gjatë periudhës 1 vjeçare të vitit të II-të, Dhjetor 2012- Dhjetor 2013 prova 3 me 112 % krahasuar me provën e I –rë me 52 % dhe provën e II-të me 56 %.

Tabela 6: Klasifikimi sipas cilësisë i fidanave.

Prova	Fidana Gjithsej	Cilësi I		Cilësi II		Jashtë standartit	
		Rrënjë	Në %	Rrënjë	Në %	Rrënjë	Në %
1.	50	8	16	28	56	14	28
2.	50	14	28	27	54	9	18
3.	50	39	78	6	12	5	10

Klasifikimi i fidanave sipas cilësisë e shprehur kjo në % në fund të viti të II-të rezulton me diferenca të dukshme midis provave. Prova 3 rezulton me 78 % të fidanave cil. e I- rë ndaj provave 1 dhe 2 respektivisht me 16 % dhe 28 %.

Tabela 7: Efektiviteti ekonomik

A. Llogaritja e të ardhurave

Prova	Të ardhura						
	Fid. C.I	Çmimi	Lekë/ardhura	Fid. C. II	Çmimi	Lekë/ardhura	Shuma Lekë
1.	8	200	1600	28	150	4200	5800
2.	14	200	2800	27	150	4050	6850
3.	39	200	7800	6	150	900	8700

B. Llogaritja e shpenzimeve

Nr	Elementët e kostos	Vlera/lekë sipas volumit të qeskës (50 qeska)		
		P.1 (2.5litër)	P.2 (3.5litër)	P.3 (5litër)
1	Vlera e qeskës	225	275	355
2	Vlera e dherishtes	1250	1750	2500
3.	Fond Page për mbjelle dhe shërbime.	1800	1900	2000
Shuma		3275	3925	4855
Kosto lekë/fidani (Cil.I + Cil.II)		82	96	108

C. Llogaritja e fitimit

Prova	Të ardhura (lekë)	Shpenzime (lekë)	Fitim (lekë)
1. Prova 1	5800	3275	2525
2. Prova 2	6850	3925	2925
3. Prova 3	8700	4855	3845

Bazuar nga tabela e mësipërme rezulton se me efektivitet më të lartë ekonomik është prova me ambalazh 5 litër në rastin e mbajtjes së fidanit në fushë për dy vjet e kushtëzuar kjo nga sasia më e bollshme e materialit ushqyes në qeskë.

**Buxheti i studimit:**

1. Pleh kimik	15 000 lekë
2. Qeska	20 000 lekë
3. Pesticide	15 000 lekë
<b>Totali:</b>	<b>50 000 lekë</b>

**5. Prova të plehimit gjethor në fidanat e ullirit me nebulizim.**

Në kuadrin e objektivave të rëndësishme që ka QTTB. Vlorë, prodhimi i fidanëve të ullirit me nebulizim është një nga detyrat për furnizimin e fidanishteve të vendit dhe fermerëve për krijimin e ullishteve të reja, prioritet ky i Qeverisë Shqiptare.

Fidanishtja përbën njërën nga hallkat më të rëndësishme në rritjen dhe zhvillimin e fidanëve të ullirit. Intensifikimi i aktivitetit të fidanishtes së ullirit dhe procedurave teknologjike është rrjedhojë e kërkesës në rritje për fidanë dhe tregëtimit për të plotësuar nevojat e fermerëve. Fidanet e ullirit duke qenë se në ditët e sotme janë të detyruara të rriten në një volum të reduktuar të dimensioneve të vazove dhe në qeska polietileni kërkon përdorimin e metodave të reja të të ushqyerit me efekt të shpejtë, për të garantuar një zhvillim dhe rritje të shëndetëshme të fidanit. Objektivi i një fidanishtje është maksimizimi i rritjes së fidanit duke kontrolluar rritjen e aksit kryesor të fidanit dhe atyre anësor për të prodhuar fidanë me parametra më cilësorë në treg.

Tre janë rrugët për të ushqyer ullinjtë e rritur në kontenitorë:

- Hedhjes së plehrave në përzierjen e materialeve që në përgatitjen e substratit fillestar
- Shtimin e plehrave të nevojshme në porcione të ndara në kohë që në të shumtën e rasteve bëhet i bashkëshoqëruar me ujët që quajtur edhe plehrim-ujtje.
- Nëpërmjet shtimit të elementeve ushqyes nëpërmjet spërkatjes gjethore.

Në praktikën moderne të prodhimit të fidanëve këto procese janë shumë të lidhur me njëri tjetrin dhe në fakt duhen të merren në konsideratë në mënyrë integrale. Në momentin e mbjelljes në kontenitorë të filizave, këto të fundit nuk kanë një aparat rrënjor shumë eficient dhe nuk janë në gjendje të thithin sasi të mëdha të elementeve ushqyes. Në këtë fazë është e nevojshme të mos e teprojmë me plehra pasi do të shkaktonim dëmtimin e filizave për shkak të fenomeneve të toksicitetit, por edhe për të ruajtur që këto elemente të shkojnë në ndotjen e ambjentit nëpërmjet shpëlarjes.

Për të shmangur këtë fenomen plehrimi në fidanishtet e sotme është riformuluar që në përgatitjen e substrateve duke përdorur plehra me tretje të ngadaltë ose me 'tretje të kontrolluar' të cilat duke qenë pjesë e substratit janë në gjendje të lëshojnë në 3-6 muajt e parë elementet ushqyes që përmbajnë.

Evolimi i teknologjisë ka bërë që shtimi i plehrave i bashkëshoqëruar me ujët të jetë metoda më e favorshme pasi jep mundësinë për të shtuar elemente ushqyes në varësi të stadi të zhvillimit të bimës. Kjo për faktin se uji është elementi që bën tretjen dhe siguron transportin e lëndëve ushqyese nga toka në të gjitha pjesët e bimës.

Plehrimi gjethor është një teknike që shfrytëzon aftësinë thithëse të pjesëve mbitokësore të bimës si të makro, ashtu edhe të mikroelementeve ku padyshim gjethja dhe sidomos në moshë të re është organi kryesor i përvetësimit të plehrave. Tashmë është i padiskutueshëm roli i madh i plehrit gjethor dhe avantazhet e tij aq sa ka hyrë si normë në të ushqyerit e bimëve dhe padyshim edhe në fidanishte. Në ditët e sotme ekziston një literaturë e pasur në lidhje me plehrimin gjethor dhe për mënyrën e trajtimit, kohëzgjatjen e trajtimit, elementet me efikasitet më të lartë, kombinimet dhe përzierjet etj.

**Qëllimi** i këtij studimi është: Të përcaktojmë drejtë se cila është mënyra më e mirë për plehrime plotësuese nëpërmjet plehrit gjethor duke përdorur plehra me përbërje të njëjtë elementesh kimike për të përcaktuar përqëndrimin dhe numrin e trajtimeve në funksion të arritjes së objektivit të prodhimit të fidanave cilësorë e me kosto sa më të ulët në kushtet e fidanishtes sonë ku mungon vaditja me pika në çdo qeskë.

#### **Materiali dhe metoda:**

Në fidanishten e prodhimit të fidanëve të ullirit në Shamogjin filizat e prodhuar në bankot e rrënjëzimit u trapiantuan në qeska 2 litra duke përdorur si substrat të tyre përzierjen e dheut me shtuf. Në vazhdim fidani në çdo afat 15-20 ditë, duke filluar nga faza e fillimit të aktivizimit

mbas trapiantimit, u bë trajtimi me plehrim gjethor duke përdorur dy lloje plehrash gjethore në dy doza të ndryshme si më poshtë:

**Prova 1:** Me plehrimin gjethor: ROSASOL - EVEN 20-20-20, NPK+ mikroelemente - çdo 15-20 ditë në përqëndrimet 1% dhe 1.5%.

**Prova 2:** Me plehrimin gjethor: Agroleaf-Poëer 20-20-20+TE, NPK+ mikroelementë- çdo 15-20 ditë në përqëndrimet 1% dhe 1.5%.

Çdo provë është bërë në një kapatë, duke shfrytëzuar në total katër kampata me fidanë të kultivarit Kalinjot.





Foto të fidanave në Prill




Foto të plehrave të përdorur






Foto nga matjet e treguesve të rritjes


Treguesit që u morrën në provë kanë të bëjnë me zhvillimin e fidanit dhe kanë qenë: Diametri i trungut (mm), 5 cm mbi qafën e rrënjës, dhe Lartësia e bimës (cm), në muajt Prill dhe Dhjetor.



Për çdo provë u maten 50 bimë në mënyrë rastësore në të njëjtën kohë për të katër provat.



Nga analiza statistikore me testin Anova rezultoi se në krahasimin në muajin Prill të mesatareve të lartësive të fidanëve nuk ka ndryshime midis fidanave në të katër kampatat kurse në analizën e po të njëjtit tregues në muajin Dhjetor rezulton se ndryshimet statistikore janë të vërtetueshme duke nxjerrë si variantin më të mirë spërkatjen e fidanave me plehun Agroleaf-Poëer 20-20-20+TE 1.5% në intervalin 20 ditë.



Nga analiza statistikore me testin Anova rezultoi se në krahasimin në muajin Prill të mesatareve të diametrit të fidanëve nuk ka ndryshime midis fidanave në të katër kampatat e njëjta gjë ndodh edhe në analizën e po të njëjtit tregues në muajin Dhjetor, megjithëse duket një avantazh i lehtë në variantin me spërkatjen e fidanave me plehun Agroleaf-Poëer 20-20-20+TE 1.5% në intervalin 20 ditë.

Si konkluzion mund të themi se spërkatja e fidanave me plehun Agroleaf-Poëer 20-20-20+TE 1.5% në intervalin 20 ditë do të ishte zgjedhja më e mirë për plehrimin gjethor në fidanishtet e ullirit. Sidoqoftë ngelet për të provuar efekti i tij në kombinim me plehrimet nëpërmjet ujitjes.

## B. Objektivi .2. Zbatimi i teknologjive në blloqet intensive (pemë, ulli, agrume).

### 1. Menaxhimi i kurorës në ullishtet intensive dhe superintensive

Në vendin tonë ky tip ullishte në sipërfaqe të kufizuara po kultivohet, pa ndonjë eksperiencë dhe përvojë pune..Në Q.T.T.B-Vlorë ka 4 vjetë që është mbjellë 0,5 ha ullishte superintensive me kultivarin Arbekuina .

Çdo vit shtohen sipërfaqe të reja me ullishte intensive e superintensive duke përmirësuar nëpërmjet eksperimentacionit shkencor kultivarët më të adoptueshëm, teknologjinë e mirërritjes, sasinë e bimëve për ha si dhe tipet e ndryshme të mekanikës bujqësore  
Studimit është i tipit “Provë”

Gjatë demonstrimit u vunë në provë për monitorim”

Në ullishten superintensive

Prova 1- dëshmuesi lënia e bimës në gjëndje të lirë pa ndërhyrje

Prova 2- lënia e bimës me një trung dhe e veshur me degëza veshëse në formë spiraleje rreth trungut

Prova 3- lënia e bimës me dy degë skelet formues

Treguesit që u monitoruan dhe përpunuan nga ana statistikore:

1-Rritja vjetore e bimëve në lartësi, gjërësi, gjatësi

2-Rritja e trungut të bimës

3-Përcaktimi i volumit të kurorës

4-Prodhimi për çdo bimë dhe provë

6-Rrezja e vajit. Kostua.

7-Efektiviteti ekonomik i ullishtes superintensive.

### Rezultatet dhe diskutimi i tyre

Ullishtja superintensive kultivari Arbekuina.

Tab.1. Përmasat e kurorës së bimëve (rritja vjetore )

Prova	Muaji Mars				Muaji Nëntor			
	D1 cm	D2 cm	H cm	Ø mm trupi	D1 cm	D 2 cm	H cm	Ø mm trupi
Prova 1	86	90	213	34	148	137	225	42
Prova 2	103	118	216	45	156	148	238	52
Prova 3	93	104	201	42	134	128	218	48

Tab 2. Volumi i kurorës m<sup>3</sup>



Prova	Mars	Nëntor
Prova 1	0,2	0,38
Prova 2	0,38	0,45
Prova 3	0,29	0,36

Tab 3


Prodhimi i realizuar sipas provave ullishte superintensive

Prova	Kg/rr
Prova 1	7,75
Prova 2	9
Prova 3	6,5


Grafik 1, 2. Prodhimi sipas provave ullishte superintensive viti III-të dhe rritja vjetore e kurorës



Ullishte superintensive



Formë e mbajtjes së kurores në gjëndje të lirë



Forma e mbajtjes së kurores me një degë skeletore



Forma e mbajtjes së kurores me dy degë skeletore

Për një veprim të tillë bima lihet me një degë skeletore që formon trupin e bimës e veshur me degëza prodhuese 1-3 vjecare në mënyrë spirale për rreth trupit të bimës. Trupi i bimës lejohet që të rritet në lartësi deri në 2,5 m

Bimët mbahen në këtë gjëndje , kjo periudhë sipas literaturës për ullishtet që vilen me kombajnë shkon deri në 15 vjet.pas kësaj kohe kur trupi i bimës është fortesuar dhe nuk lejon përkulje bëhet rinovimi i kurorës duke e prerë pjesën mbitokësore mbi qafën e rrënjës me mundësi të çeljes së lastarëve të rinj nga i njëjti kultivar që shërben për marjen e prodhimit..

Në vendin tonë ky tip ullishtje ka pak vite që kultivohet.

Janë të pakët fermerët që kanë mbjellë në sipërfaqe të kufizuara përvec një shoqate fermerësh në qarkun e Kavajës që ka mbjellë deri në 1000 ha .Për të tilla ferma futja e mekanikës në vjeljen e ullirit do të ishte me shumë interes në drejtim të kursimit të fuqisë punëtore dhe uljes se kostos së prodhimit.

Ndërsa për fermerët që kanë nga 0,5 -1 ha ullishte superintensive as që mund të bëhet fjalë për vjelje më kombajnë.Këta fermer do të vjelin me dorë duke përdorur mekanizma të tjerë të thjeshtë dhe pak të kushtueshëm

Në vitin e parë të studimit vërejmë se rritje vjetore më e madhe është realizuar në proven e II-të duke e lenë bimën me një trup, në krahasim me provën ku bimet janë mbajtur në dy degë skeletore .

Në provën e II-të ku bimët janë mbajtur me një degë skeletore është realizuar dhe rendimenti më i lartë duke e krahasuar me dy provat e tjera

Në provën e III-të ku bimët janë mbajtur me dy degë skeletore rritja dhe prodhimi është më i vogël për aresye të ndërhyrjes që u bënë në bimë për formimin e kurorës.Është me interes që të shikojmë vitin pasardhës dhe më vonë se si do të shkojnë këta tregues.

Rezultatet e vitit të parë në ullishten intensive pas vitit të III-të mbjelljes në kultivarin Frantoio na tregojnë për një epërsi të demonstrimit në provën e tretë ku është zbatuar dhënia e formës së mbajjes së kurorës kupore me 3 degë skeletore jo vetëm për rritje vegjetative por dhe në rendimentin e realizuar për cdo provë .

Duke qënë në vitin e parë të prodhimit ndryshimi është shumë i vogël midis provave .në analizën e variancës ky ndryshim nuk përbën një arritje për tu marrë në konsiderat sepse kemi të bëjmë me një grup homogjen, por ashtu dhe në këtë kategori ullishte ndryshimet do të shihen në vitet në vijim.

Foto.Ullishte superintensive .Aspekte nga punimi dhe plehërimi kimik



## 2- Aplikimi i teknologjisë më optimale (menaxhimi i tokës, kurorës, parazitëve etj.) në resurset gjenetike (ullishte, pemë frutore, vreshta).

Janë hartuar kartat teknologjike për të gjitha kulturat dhe terrenet në parcelat me drufitorë në bazën eksperimentale prodhuese në shamogjin. (Shif në aneksin 1 bashkangjitur).

### 3. Modele tekniko- ekonomike të ullishteve

Në parcelën e ngritur pranë bazës eksperimentale Shamogjin, janë kryer të gjitha shërbimet e planifikuara konform metodikës si dhe janë marë treguesit e planifikuar.

Është ndjekur në vazhdimësi e curia e parcelave “pilot” të ullirit në fshatrat Dukat, Vezhdanisht, Çepirat e Armen dhe gjëndja e tyre paraqitet mjaft e mirë. ( aneks 2 )

## C. Objektivi 3. Përgatitja e specialistëve dhe fermerëve nga ana teorike praktike me koncepte të reja për menaxhimin e kulturave drufitorë.

### 1.Seminare & konferenca

Data	Tema e trajtuar	Seminar	Konferenca	Personi
22.3.2013	Rjeti nderkombetar për mbështetjen e SMV-ve në sektorin e mbarështrimit të kafshëve dhe hortikulturë	Seminar kombëtar		A.Llambro
29 .8 2013	Shartimi i dyfishtë te kultura e kajsisë		Konferenca Alba shkenca	A Llambro

### 2. Demonstrime



Data	Tema e trajtuar	Pjesemaresit	Personi
18.2.2013	Rikonstruksioni i ullishteve	Ekstensioniste dhe fermerë të rrethit Vlorë	Z.Veshaj E.Braho
25.2.2012	- Krasitja prodhuese në ulli - Rikonstruksioni i ullishteve	Ekstensioniste dhe fermerë të rrethit Elbasan	Z.Veshaj L.Lazaj
17.4.2013	Krasitja prodhuese në ulli	Ekstensioniste dhe fermere të rrethit Tiranë	Dh.Panajoti R.Merko A.Lazaj
2.5.2013	Krasitja prodhuese në ulli	Ekstensioniste dhe fermerë të rrethit Elbasan	Dh.Panajoti R.Merko A.Lazaj A.Llambro E.Braho

### 3. Ditë fushe

Data	Tema e trajtuar	Pjesemaresit	Personi pergj.
3.4.2013	Promovimi dhe vlerësimi organoleptik i verërave të 5 cv. Autoktonë të rrushit.	Stafi i drejtorisë së transferimit të teknologjive	H.Fiku E.Braho
13.5.2013	Njohja me teknologjinë e prodhimit të fidanave të ullirit me nebulizim në serrë.	Studente të U.B.Tiranë.	Dh.Panajoti R.Merko
7.6.2013	Demonstrim i teknologjisë në ullishtet intensive dhe superintensive	Ekstensionistë të Q.R.B.U.M.K. Vlorë dhe fermerë të zonës	Z.Veshaj
19.6.2013	Polenizimi artificial ne shtimin e rendimentit te cv. Kallmet	Ekstensioniste te Q.R.B.U.M.K. Lezhe	I.Fiku
26.9.2013	Teknika të mbrojtjes nga miza e ullirit në KMB	Ekstensionistë të Q.R.B.U.M.K. Berat	M Bacaj





Demonstrim i teknologjisë në ullishtet intensive dhe superintensive




Promovimi dhe vlerësimi organoleptik i verërave të 5 cv. autoktonë të rrushit

**4.Trajnime të hapura me ekstensioniste dhe fermere.**



<b>Data</b>	<b>Tema e trajtuar</b>	<b>Vendi</b>	<b>Personi</b>
18.2.2013	Teknikat e përdorimit të herbicideve në drufrutorë	Q.R.B.U.M.K. Fier	M.Baçaj
18.2.2013	Rajonizimi i prodhimit bujqësor, domosdoshmeri. për të zbatuar rekomandime për studimet	Q.R.B.U.M.K Vlorë	E.Braho
18.2.2013	Teknologjia e kultivimit të luleshtrydhes	Q.R.B/U.M.K. Fier	A.Llambro
18.2.2013	Periodiciteti në prodhimin. e ullirit. Masat për shmangien e fenomenit	Q.R.B.U.M.K Vlore	Z.Veshaj
18.2.2013	Metodat më të mira për rikonstruksionin e ullinjve të degraduar.	Q.R.B.U.M.K Vlore	Z.Veshaj
19.2.2013	Miza mesdhetare.	Q.R.B.U.M.K Vlore	M.Baçaj
19.2.2013	Dëmtuesi i ullirit Acelia olea	Q.R.B.U.M.K. Vlore	M.Baçaj
4.3.2013	Periodiciteti në prodh. E ullirit. Masat për shmangien e fenomenit	Rrethi Sarande	Z.Veshaj
4.3.2013	Metodat më të mira për rikonstruksionin e ullinjve të degraduar.	Rrethi Sarande	Z.Veshaj
17.4.2013	Ndikimi i krasitjes per te eliminuar prodhimin periodik ne ullishte.	Durres	Z.Veshaj
17.4.2013	Ndikimi i krasitjes per te eliminuar prodhimin periodik ne pemtore	Durres	A.Llambro
21.5.2013	Operacionet e gjelbera ne vreshta	Shkoder	I.Fiku
21.5.2013	Teknologjia e ullishteve superintensive	Shkoder	Z Veshaj
21.5.2013	Prodhimi i fidanave të çertifikuar	Shkoder	E.Spahiu
14.6.2013	Ligji i prodhimit të fidanave, çertifikimi, standartet.	Berat	A.Llambro E.Spahiu
14.6.2013	Luftimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve në kulturën e ullirit.	Berat	M.Baçaj
14.6.2013	Prodhimet bio në vresht dhe pemë.	Berat	I.Fiku
15.9.2013	Njohja me kultivarët e përshtatshëm të pemëve ,ullirit dhe rrushit	Vlore	I Fiku, Z Veshaj





Trajnim me specialistë në DRBU Shkodër



Trajnim me specialistë nDRBU në Durrës



Trajnim me specialistë në DRBU Fier



Trajnim me specialistë DRBU Vlorë

### 5. Biseda ne television.


Data	Televizioni	Tema e trajtuar	Personi
7.2.2013	„Apollon”.	Prodhimi i fidanave të ullirit me nebulizim	A.Llambro, M.Baçi, A.Lazaj
8.2.2013	“ T.V.SH”	Cilësitë e vajit të ullirit dhe funksioni i “panel-test”.	A.Veizi
	“ T.V.SH”	Interviste A1 Report.	A.Veizi
12.4.2013	“Apollon”	Trajtimet e momentit në pemë, vreshtë e ulli	H.Fiku Z.Veshaj R.Merko
	T.V. Klan	“Pasdite në klan” Mbi cilësitë e vajit te ullirit.	A.Veizi
3.12.2013	T.V Apollon	Shërbimet dimërore në pemë frutore e ulli	M Bacaj Z Veshaj A Llambro




#### Objektivi 4. Projekte të kërkimit në fermë

Për vitin 2013 janë zhvilluar 4 projekte të kërkimit në fermë:


N/r	Titulli i temës	Rrethi	Fshati ku u ngrit	Personi që e ndjek
1	Rikonstruksioni i ullishteve	Vlorë, Elbasan	Oshëtime Ullishte	Z.Veshaj L.Lazaj
2	Krasitja prodhuese në ulli	Tiranë Elbasan Fier	Vorë Qytet Cakran	A.lazaj E.Braho R.Merko
3	Monitorimi dhe luftimi i mizës mesdhetare në agrume.	Sarandë	Xarë	M.Bacaj A.Llambro L.Xhelilaj
4	Teknika të mbrojtjes nga miza e ullirit në cv. Kokër Madh Berati	Berat	Velabisht	M.Bacaj R.Merko



Monitorimi dhe luftimi i mizës mesdhetare në agrume rrethi Sarandë



Rikonstruksioni i ullishteve të degraduara Fier



Krasitja prodhuese në ulli Tiranë

Projekti I. Realizimi financiar vjetor 2013. (000 lek)

Aktiviteti		
	Plan	Realizim
<b>Obj. 1. Teknologji dhe teknika në prodhimin e materialit bimor të ullirit.</b>		
Aktivitetet:		
- Përcaktimi i moshës më optimale të copave të ullirit për rrënjëzim	50	50
-Prodhimi i fidanave të ullirit me nebulizim duke përdorur raporte të ndryshme substrati ushqimor në qeskat e rritjes.	65	65
4 -Ndikimi i përdorimit të ambalazheve të dimensioneve të ndryshme në rritjen dhe zhvillimin e fidanave të ullirit.	50	50
5. Prova të plehrimit gjethor në fidanat e ullirit me nebulizim	50	50
<b>Obj.2. Zbatimi i teknologjive në blloqet intensive (pemë, ulli, agrume).</b>		
Aktivitetet:		
- Menaxhimi i kurorës në ullishtet intensive dhe superintensive	83	83
- Aplikimi i teknologjisë më optimale (menaxhimi i tokës, kurorës, paraziteve etj.)në resurset gjenetike (ullishte, pemë frutore, vreshta).	-	-
- Modele tekniko- ekonomike të ullishteve	180	180
<b>Objektivi 3. Përgatitja e specialistëve dhe fermerëve nga ana teorike praktike me koncepte të reja për menaxhimin e kulturave drufrutore</b>		
- Trajnime	44	40
- Demonstrime – dite fushe	31	31
<b>Objektivi 4. Projekte të kërkimit në fermë</b>		
- . Rikonstruksioni i ullishteve.	30	30
- Krasitja prodhuese në ulli	34	34
.- Monitorimi dhe luftimi i mizës mesdhetare në agrume.	41	41
-4. Teknika të mbrojtjes nga miza e ullirit në cv. Kokër madh Berati.	47	47
TOTALI	750	750

## II. Projekti 2 : “Menaxhimi i resurseve gjenetike (pemë frutore, hardhi, ulli dhe agrume) dhe shtimi i materialit bimor

### A. Objektivi 1. Eksplorimi dhe grumbullimi resurseve gjenetike në pemë frutore (qersh, kumbull, dardhe, shege, fiq etj), ulli e hardhi

Për vitin 2013 u eksploruan zonat e Përmetit dhe të Gjirokastrës të parashikuara në program Në muajin Maj dhe Qershor, Shtator dhe në vazhdim grupi i specialisteve të përbërë nga Dh. Panajoti, A. Llambro, H. Fiku, A. Lazaj, L. Xhelilaj, M. Bacaj organizuan ekspeditat për eksplorimin e resurseve gjenetike autoktonë të pemëve frutore, ulli, hardhi në këto zona. Puna e këtyre ekspeditave ishte gjetja dhe identifikimi i aksesioneve të rralla të pemëve frutore ullirit e hardhisë. Këto aksesione janë gjetur në kopshte dhe oborre të shtëpive në këto zona. Aksesionet e gjetura dallohen për prodhimtari të mirë dhe shije të veçantë, rezistencë ndaj kushteve klimatike, qëndrueshmëri nga sëmundje dhe dëmtues. Për çdo aksesion të gjetur është bërë etiketimi i bimëve për marrjen e materialit për shtim të këtyre aksesioneve.

Grupi i specialistëve evidentoi disa aksesione të pemëve frutore si : arra; fiq, shegë, kumbulla disa aksesione rrushi dhe ulliri.

Për çdo aksesion të gjetur u bënë fotot dhe u plotësuan skedat e thjeshta : vendndodhja e tyre, emri, sinonimet, moshja si dhe disa karakteristika kryesore të aksesioneve të gjetur.

Aksesionet e gjetur :

Arra

Arra e Leskovikut, Arra guacke hollë, Arra e madhe.

Fiku.

Fiku i zi, Fiku i vogël për tharje, fiku i kuq me rrema,

Kumbulla

Kumbulla e verdhë, Kumbulla gjgande.

Shega

Shega kokërrmadhe, shega e ëmbël e Përmetit.

Rrush


Larushka

Ulliri.

Ulliri i Bualit,



Arra ( Leskovik)



Shegë (Përmet)



Rrush Larushkë (Përmet)

## **B. Objektivi 2 Pasurimi i koleksioneve me kultivarë të tjerë autoktonë**

### **1.Mbjellja e aksesioneve të kumbullës ,dardhës dhe fikut në koleksionin e pemëve frutore autoktone**

Në pjesë e këtyre aksesioneve të disa specieve kanë shfaqur veti shumë të mira dhe është menduar për ngritjen e parcelave me një numër më të madh për disa specie. Për këtë është bërë puna paraprake duke kontaktuar me fidanishtet që prodhojnë fidane autoktone. U lidhën kontrata me fidanishtet për prodhimin e këtyre fidanëve.

Aksesionet që do të shtohen këtë vit janë :



1.dardha elbje , 2. dardha Dimërore, 3. Kumbulla Vlonjate, 4. Kumbulla Tropojane.

### **2.Promovimi i verërave dhe vajit të ullirit me kultivarë autokton**

U realizuar në Q T T B promovimi i 5 kultivarëve të verërave autoktone ( Shesh i Bardhë, Shesh i Zi , Debinë e Bardhë, Vlosh dhe Kallmet) me pjesëmarrjen e specialistëve.

U degustuan dhe u bë vlerësimi i 5 lloje verërash . Vlerësimi u bë mbi bazën e një skede enologjike ku ishin të shënuara karakteristikat si; ( shija kthjelltësia buketi)

Promovimi i vajit aktiviteti i realizuar në Q T T B për 12 kultivarë autoktonë të ullirit me pjesëmarrjen e specialistëve të vendit e të huaj .




## **C. Objektivi 3. Studimi i specieve kumbull e dardhë në koleksionin e pemëve frutore autoktone**

Në koleksionin e pemëve frutore autoktone gjatë vitit 2013 u përcaktuan dy speciet kryesore dardhë e kumbull.

Për këto specie u studjuan : fenofazat , Koha e lulëzimit , lidhja e frutit, koha e pjekjes së frutit. Zhvillimi i bimës , rritja e vjetore e kurorës dhe trungut.


Për çdo fenofazë janë bërë fotot dhe janë mbajtur shënimet përkatëse.




Lulezimi në specien dardhë




Faza e rritjes së frutave




Kumbulla e kuqe






Kumbulla sheqeri





Lulëzimi në specien Kumbull



Rritja tek kumbulla



Dardha Roshnik



Dardhë Gushti

#### D. Objektivi 4. Kontrolli i materialit bimor

##### 1. Hartimi i protokolleve të trajtimeve për ullishtet mëmë

U hartua kalendari i trajtimeve të sëmundjeve dhe dëmtuesve në ullishtet mëmë për periudhën gjithëvjetore dhe është ndjekur zbatimi i tij.

Në bashkëpunim me UBT Departamentin e Mbrojtjes së Bimëve janë kryer analizat për nematodet dhe verticilium.

Kontrollet vizive realizohen mbi materialin bimor të ullirit që ndodhet në fidanishte. Periudha e kontrolleve vizive, periodiciteti për çdo specie dhe patogjen pasqyrohet në tabelle:

Sëmundje dhe/ose patogjenë	Kontrollet vizive			
	Organ i vrojtuar	Simptomat	Periudha e vrojtimit	Periodiciteti
<b>Virus</b> SLRV ArMV CLRV OLYiV	Gjethë dhe fruta	Zverdhje gjethore dhe keqformim i frutave	Pranverë dhe ngjyrosje fruti	Çdo vit
<b>Kerpudhat</b> Vericillium dahlie	Kurora	Rënie e gjethëve dhe tharje e sytheve dhe/ose degëve	Nga prilli deri në shtator	Çdo vit
<b>Bakteret</b>	Kurora	Tuberkulat	Në pranverë dhe vjeshtë- dimer	Çdo vit


## 2.Zbatimi i teknologjive në pemtore, ullishta e vreshta

Në bazën e Shamogjinit për çdo kulturë ( pemë frutore,ulli,agrume,rrush) u hartuan kartat teknologjike sipas veçantisë së çdo kulture

Ndjekja e shërbimeve në të gjitha parcelat është bërë duke ju përmbajtur kohës dhe mënyrës së përcaktuar në preventiva. (aneks 3 preventivat)



Koleksioni autokton i pemëve frutore




Koleksioni i vreshtit



Parcela superintensive





Fusha e rritjes së fidanëve të ullirit



Parcela e ullirit superintensive

### 3. Testimi i kultivareve autokton sipas CPOV

Me të dhënat e mara në koleksionin e pemëve frutore autoktone janë plotësuar skedat tip sipas UPOV për aksionet e studiuara të specieve të kumbullës dhe dardhës



## RAPORT VJETOR I PUINËS VITI 2013

PEAR	dardha Dimerore	COLLNUMB				
						
<b>DESCRIPTOR NAME</b>	përshkruesi	<b>DESCRIPTOR RANKING</b>				
<b>TREE: VIGOUR</b>	Fuqia e pemes	3 (weak)	5 (medium)	7 (strong)	medium	
<b>TREE: HABIT</b>	vendndodhja	1 (upright)	2 (spreading)	3 (drooping)	4 (weeping)	spreading
<b>FRUIT: RATIO/LENGTH DIAMETER</b>	Raporti / gjatësi diametër	1 (very small)	3 (small)	5 (medium)	7 (large)	
<b>FRUIT: SIZE</b>	madhësia	3 (small)	5 (medium)	7 (large)	medium	
<b>FRUIT: PROFILE OF SIDES</b>	profili anesor	1 (concave)	2 (straight)	3 (convex)		
<b>FRUIT: SKIN GROUND COLOR</b>	Ngjyra dalluese e frutit	1 (not visible)	2 (green)	3 (yellow-green)	4 (yellow)	
<b>FRUIT: RELATIVE AREA OF OVERCOLOR</b>	shpërndarja e ngjyres në frut	3 (small)	5 (medium)	7 (large)		
<b>FRUIT: HUE OF OVERCOLOR</b>	vendosja e ngjyres	1 (orange)	2 (orange red)	3 (pink red)	4 (light red)	
<b>FRUIT: LENGTH OF STALK</b>	gjatësia e bishtit	3 (short)	5 (medium)	7 (long)		
<b>FRUIT: THICKNESS OF STALK</b>	Trashësia e bishtit	3 (thin)	5 (medium)	7 (thick)		
<b>FRUIT: DEPTH OF STALK CAVITY</b>	Thellësia e bishtit në zg	3 (shallow)	5 (medium)	7 (deep)		
<b>FRUIT: DEPTH OF EYE BASIN</b>	Fruta: Thellësia e EYE P	3 (shallow)	5 (medium)	7 (deep)		
<b>FRUIT: WIDTH OF EYE BASIN</b>	: Gjerësia e vendit të ve	3 (narrow)	5 (medium)	7 (broad)		
<b>FRUIT: FLESH TEXTURE</b>	Texture e tullit	3 (fine)	5 (medium)	7 (coarse)		
<b>TIME OF BEGINNING OF FLOWERING</b>	Koha e fillimit të lulëzimit	record the date when 10% of flowers are open				
<b>TIME OF MATURITY FOR CONSUMPTION</b>	Koha e pjekjes për konsum	record the decade when the first fruit ripens				
<b>EATING QUALITY</b>	cilesia e ngrenies	3 (low)	5 (medium)	7 (good)		good
<b>FRUIT TASTE</b>	shija e frutit	sweet	equilbrate	acid		sweet
Map of the field; pictures, drawings	Additional Information from the interview					
<b>LEGENDA DESCRIPTORS</b>						
# 44						
1 = not visible	1 = nuk është e dukshme					
2= green	2 = green					
3 = yellow green	3 = verdhë e gjelbër					
4= yellow	4 = të verdhë					

Skeda e plotësuar për aksesion të kumbullës

								
	<b>PLUM</b>		<b>COLLNUMB</b>					
<b>EC</b>	<b>TP</b>	<b>DESCRIPTOR NAME</b>	<b>DESCRIPTOR RANKING</b>					
<b>PE</b>	<b>OV</b>							
1		<b>TREE: VIGOUR</b>	Fuga e pames	3 (weak)	5 (medium)	7 (strong)		strong
2		<b>ONE -YEAR-OLD SHOOT ATTITUDE</b>	Qendrimi i lastarit nje vjecar	1 (erect)	3 (semi-erect)	5 (horizontal)	7 (drooping)	drooping
3		<b>FRUIT: SIZE</b>	Madhesia e frutit	3 (small=11-25 g)	5 (medium=26-40 g)	7 (large=41-55 g)		medium
4		<b>FRUIT: SHAPE*</b>	Forma e frutit	1-7 (*see legenda below)				elliptic
5		<b>FRUIT: DEPTH OF STALK CAVITY</b>	Thelësia e bishitit te frutit ne zgavrën	3 (shallow)	5 (medium)	7 (deep)		shallow
6		<b>FRUIT: GROUND COLOR*</b>	Ngjyra e frutit	1-9 (*see legenda below)				purple red
7		<b>FRUIT: COLOR OF FLESH*</b>	Ngjyra e tullit	1-6 (*see legenda below)				yellow
8		<b>FRUIT: FIRMINESS OF FLESH</b>	Qëndrueshmëri e tullit te frutit	3 (soft)	5 (medium)	7 (firm)		soft
9		<b>FRUIT: ADHERENCE OF STONE TO FLESH</b>	Lidhja e berthames me tulin	1 (freestone)	2 (semi-freestone)	3 (clingstone)		freestone
10		<b>STONE: GENERAL SHAPE (in lateral view)</b>	forma e përqjithshme (në pikëpamje laterale)	1 (rounded)	2 (ovate)	3 (elliptic)		elliptic
11		<b>STONE: SHAPE (in ventral view)</b>	forma e berthames (në pikëpamje barkut)	1 (narrow elliptic)	2 (elliptic)	3 (broad elliptic)	4 (conate)	elliptic
12		<b>TIME OF BEGINNING OF FLOWERING</b>	koha e fillimit të lulëzimit		record the date when 10% of flowers are open			april
13		<b>TIME OF BEGINNING OF FRUIT RIPENING</b>	Koha e fillimit te pjekjes se frutit		record the decade when the first fruit ripe			august
14		<b>EATING QUALITY</b>	Cilesia e frutit	3 (low)	5 (medium)	7 (good)		medium
15		<b>FRUIT TASTE</b>	Shija e frutit	sweet	equilibrate	acid		acid
<b>REMARK</b>		Map of the field; pictures, drawings		Additional Information from the interview				
		<b>LEGENDA DESCRIPTORS</b>						
			# 36 & 50 (after removal of prunes)	# 40 & 44	# 51			
		1 = whitish		7 = purple red	1 = rounded flat	1 = whitish		
		2 = green		8 = violet blue	2 = round	2 = green		
		3 = yellow green		9 = dark blue	3 = elliptic	3 = yellowish green		
		4 = yellow			4 = elongated elliptic	4 = yellow		
		5 = orange			5 = ovate	5 = orange		2 (semi-freestone)
		6 = red			6 = heart shaped	6 = red		
					7 = drop shaped			

( shih aneksin 4 )

## Realizimi i buxhetit për projektin 2

**Objektivi 1.** Eksplorimi dhe grumbullimi resurseve gjenetike në pemë frutore (qershi, kumbull,

Nr	Aktiviteti	Buxhetii detajuar ne mije lek	Realizimi vjetor	Realizimi %
1	Eksplorimi i resurseve autoktonë të pemëve frutore, ulli, hardhi në zonën e Permet Gjirokaster..	200 (dieta)	100	50
	Grumbullimi i resurseve në pemë frutore ulli e hardhi në zonën e Përmetit dhe Gjirokastrës	100 (dieta)	60	60

**Objektivi 2** Pasurimi i koleksioneve me kultivarë të tjerë autoktonë ( 20 aksesione x 5 bimë për çdo aksesion )

Nr	Aktiviteti	Buxhetii detajuar në mijë lek	Realizimi vjetor	Realizimi %
1	Shtimi dhe mbjellja e tyre në koleksionin autoktonë të pemëve frutore	150 Blerje fidanë	150	100
2	Promovimi i verërave dhe vajit të ullirit me kultivarë autokton	100 ( 50 shishe ) (50 Etiketa)	100	100
3	Plotësimi i D.Base i të dhënave të aksesioneve në koleksionin autokton të pemëve frutore	-		

**Objektivi 3** Studimi i specieve kumbull e dardhë në koleksionin e pemëve frutore autoktone

Nr	Aktiviteti	Buxhetii detajuar ne mije lek	Realizimi vjetor	Realizimi %
2	Studimi i aksesioneve në speciet dardhë dhe kumbull në koleksionin autokton të pemëve frutore	50 (reagentë për kryerjen e analizave)	50	100

**Objektivi 4.** Kontrolli i materialit bimor

Nr	Aktiviteti	Afati	Buxhetii detajuar ne mije lek	Realizimi vjetor	Realizimi %
	Hartimi i protokolleve të trajtimeve për ullishtet mëmë	Janar 2013			
	Plotesimi i skedave të kultivarëve sipas CPOV	Tetor Dhjetor 2013			
	Zbatimi i teknologjive për mirëmbajtjen e sipërfaqes prej 27.2 ha ha	Janar-dhjetor 2013	2200	2200	100
	. Protokolle trajtimesh për të gjithë materialin bimor (protokolle vizual dhe laboratorik)	Janar – Dhjetor 2013			
	Testimi i kultivareve autokton sipas CPOV	Shtator Dhjetor 2013			

### III. Projekti 3.

#### **A. Studimi 1 “Sisteme të ullishtarisë me efektivitet të kufizuar. Aspekte tekniko-ekonomike të menaxhimit”.**

##### **1. Justifikimi i kërkimit**

Referuar aspekteve agronomike, edhe pse në kushte të ndryshme bio-agronomike dhe produktive që hasen në zona të ndryshme, ky tip ullishtarie karakterizohet nga një ekstremitet heterogjen, plakje të bimëve, prodhim i kufizuar dhe jo i regullt dhe vështirësi mekanizimi të operacioneve kulturale.

Në disa zona kultivimi ullirit është spostuar shpesh në gjëndje marginale për shkak të pjerrësisë ose pjellorisë tokës, ku, shtrirja e kulturave të tjera mund të ofronte alternativa të tjera të vlefshme ekonomike. Shumë terrene të dedikuara kësaj ullishtarie janë pakë pjellore dhe të varfëra në lëndë ushqyese dhe organike. Në raste të tjera ullishtet shtrihen në terrene akoma më të pjerrëta, subjekt i gërryerjeve të forta, që, me kalimin e kohës, e bëjnë atë më të varfër.

Prodhimet modeste dhe mbi të gjitha vështirësitë e mekanizimit të operacioneve kulturale kanë përcaktuar në shumë zona rritje të ndjeshme të fermave të ullishtarisë të drejtuara nga vetë pronarët. Në fakt këto janë unike në gjëndje të superojnë nivele të caktuara të kostove të prodhimit.

Copëzimi tokës së mbjellë me ullishte, nëqoftëse nga njëra anë ka bërë që këto ferma të mbijetojnë edhe në kushte të vështira, nga ana tjetër ka qënë një pengesë për futjen e teknologjive të reja.

Kjo gjëndje sot ka përcaktuar në shumë zona me ullishtari marginale abandonimin e kultivimit edhe pse vazhdojnë të egzistojnë bimë ulliri. Shpenzimet reduktohen në masë dhe vjelja bëhet vetëm kur prodhimi dhe cmimi i vajit kompeson mjaftushëm punën, princip kryesor në këtë situatë.

Është në fakt nëpërmjet zgjedhjes së kombinacioneve produktive më të përshtatshme me karakteristikat e njësive prodhimit që mund të na bëjë të afrohem përdorimit të plotë të faktorëve të prodhimit dhe si rezultat rritjen e shkallës së produktivitetit.

Nga kjo buron karakteri unik i zgjedhjeve organizative të njësive prodhimit bujqësor që, duke zgjidhur problemin e efencës, shikon njëkohësisht të përcaktuar sistemin kompleks të organizimit.

II. Qëllimi i studimit : Zhillimi dhe kolaudimi i strategjive të menaxhimit të përshtatshëm në kushte të ndryshme kulturale dhe sociale, në gjëndje të prodhojë të mira ekonomike për fermat, shpesh me investime të kufizuara. Të analizojë karakteret emergjente të menaxhimit agronomik dhe të mekanizimit, rezultatet tekniko-ekonomike dhe prespektivat e zhvillimit

##### III. Materiali dhe metoda

Në shkallë vendi ullishtaria jo efektive zë rreth 30 % të sipërfaqes së mbjellë ose afërsisht 1.5 milionë rrënjë\*, duke shtuar dhe numurin e rrënjëve të ullishteve tradicionale 40-50 vjecare, në kushte të përafërta kultivimi dhe prodhimi, shifrat dyfishohen.

Është tipike e atij realiteti ullishtarie karakteristika si : shtrirja mbi 25 % pjerrësi, tokë e taracuar, bimë shumë të vjetra dhe me kurorë të lartë, coptim të parcelave ku shtrihet. Në këto kushte produktiviteti është i kufizuar dhe kostot e prodhimit janë shumë të larta.

Nëpërmjet realizimit të këtij studimi, duke evidentuar sistemet e menaxhimit, gjëndjen në tërësi të këtyre ullishteve dhe duke përcaktuar praktikat më efektive të prodhimit, do të mund të kontribuojmë në sensibilizimin e opinionit të fermerëve për të ndryshuar qëndrim ndaj gjëndjes dhe për t'u angazhuar seriozishtë në përmirësimin e saj.

Studimi u realizua në qarqet : Vlorë, Tiranë dhe Elbasan me kultivarë autokton. Në këto qarqe ndodhet rreth 50 % e sipërfaqes së ullishteve egzistuese, realizohet 47 % e prodhimit në shkallë vendi. Janë përfshirë në studim 40 ferma që kultivojnë varietetet : Kalinjot për qarkun e Vlorës, Ullirin e Bardhë të Tiranës për qarkun e Tiranës dhe Mixan për qarkun e Elbasanit, tre kultivarët më dominantë në këto qarqe.

Për grumbullimin e të dhënave u hartua një skedë me treguesit e planifikuar për realizimin e tij. Të dhënat u morën nëpërmjet intervistës së kryer fermerit për vitin 2012. Fermat u zgjodhën me qëllim që të përfaqësonin kushtet e kultivimit të këtyre varieteteve në këto zona ullishtarie, nga më të mëdhatë në shkallë vendi.

Nga pikpamja metodologjike është ndjekur një radhë llogjike e fazave të studimit të sintetizuar në këtë mënyrë :


1. Teknikat agronomike apo kulturele të aplikuara në ullishte
2. Teknikat produktive (mjete të thjeshta apo mekanike në kryerjen e operacioneve kulturele)
3. Funkzioni i zgjedhjes teknologjike me parametra të kostos minimale për njësi sipërfaqe ose për njësi produkti.

Për cdo tip ullishte është evidentuar :

1. Kosto e prodhimit për njësi të ullinjve dhe vajit të ullirit
2. Kosto e vjeljes për njësi
3. Treguesit e të ardhurave për tipe të ndryshme ullishtesh

### 1. Karakteristika të fermës

Tabela 2 : Tipi fermës





Nga të dhënat rezulton se 82 % e fermave të studjuara janë familjare, karakteristike e menaxhimit të kësaj ullishtarie me sipërfaqe e numur rrënjësh të kufizuara. Vetëm 18 % e fermerëve punësojnë të tretë për të plotësuar nevojat e prodhimit.

Sipërfaqja për fermë e mbjellë me këtë tip ullishtë shkon rreth 0.6 ha, ndërsa në prodhim 0.4 ha. Rreth 85 % e saj shtrihet në kodra të larta. Mbizotëron tipi i ullishteve me 90 bimë/ha, mbi 50 vjecare dhe pothuajse e tëra mbi ujë. Përgjithësishtë ferma ushtron aktivitet

të përzier dhe realizon përafërsishtë : 29 kg/rrënjë ulli dhe 6 kg/rrënjë vaj ulliri. Familja fermere konsumon në vit : 2 kv ulli dhe 0.9 kv vaj ose përkatësishtë : 40 kg/frymë ulli dhe 18 kg/frymë vaj ulliri. Niveli i pranushëm i këtyre dy treguesve është privilegj i të gjitha zonave me ullishtari.

### 2. Disa të dhëna financiare të fermës




Të ardhurat nga ullishtaria zënë vetëm 51 % të të ardhurave gjithsej. Për këto tipe ullishtesh, ferma, në veprimtarinë e saj prodhuese, rezultojnë me humbje. Për çdo rrënjë ulli shpenzohet mesatarisht 2971 lekë ose më pak se 2 ditë pune dhe fitohet 2281 lekë. Me teknikat produktive që zbatohen sot, me apo pa ujë, me ose pa plehrim, të trajtuara ose jo me pesticide, edhe për vitin 2012 në të cilin prodhimi është 33 % më i lartë se vitin e kaluar, bilanci rezulton negativ. Me gjithatë, në kushte të përafërta prodhimi, 25 % e fermave të studjuara rezultojnë me bilanc pozitiv, fakt që tregon se, me zgjedhje të përshtatshme të strategjive të menaxhimit dhe teknikave kulturore produktive, janë të gjitha mundësitë e rritjes së efektivitetit të fermës së ullishtarisë.

IV. Rezultate dhe diskutime

Nga të dhënat e studimit, për 3 qarqe, kemi evidentuar rreth 23 sisteme menaxhimi të tipit të ullishteve të përfshira në të. Sisteme të plota menaxhimi janë konsideruar rastet kur fermeri ka kryer të gjitha shërbimet agroteknike, të pjeshme kyr janë bërë shërbimet më të domosdoshme si : krasitja etj, dhe pa shërbime në rastin kur nuk është bërë asnjë ndërhyrje.

Grafiku 1 : Sistemet e menaxhimit të ullishteve(shërbime agroteknike)

Nga të dhënat e grafikut del se vetëm 30 % e fermave impenjohen seriozisht në kryerjen e shërbimeve agroteknike të domosdoshme, megjithë



vështirësitë e shumta si : terrene të pjerëta, mungesa e infrastrukturës dhe e mjeteve dhe agregateve bujqësore të përshtatshme për këto kushte, volumi i madh i kurorës dhe rritja eçesive e bimës së këtyre kultivarëve etj. Ndërsa në 55 % të fermave kryhen shërbime të pjeshme për vështirësi të përmendura, por të një shkalle më të madhe. Duhet theksuar se janë konsideruar sisteme dhe kryerja e një apo dy shërbime të vetme dhe janë përfshirë në kategorinë e

dytë. Sipas të dhënave të marra nga skedat në 15 % të fermave këtyre ullishteve nuk u shërbehet, me tendencë kjo për t'u rritur po të përfshijmë në këtë kategori edhe sistemet me një shërbim të llogaritura si të pjesëshme.




Grafiku 2 : Realizimi i prodhimit kv/ha sipas sistemeve të menaxhimit

Referuar të dhënave prodhimi për ha ulet gati 2 herë në mungesë totale ose të reduktuara të shërbimeve, krahasuar me sistemet e plota të shërbimeve. Diferenca të ndjeshme në prodhim vihen re edhe tek sistemet e

pjeshme, që ndikojnë dukshëm në të ardhurat për ha. Pa hyrë në detaje se cilat shërbime kryhen ose nuk kryhen në dy sistemet e para, mjaftojnë të dhënat e grafikut për të sensibilizuar opinionin fermer se edhe në këto tip ullishtesh, me një përkujdesje më të madhe, mund të arrihen rezultate të mira ekonomike dhe kjo pasuri kaq e çmuar për vendin tonë të kthehet në rentabël.

Grafiku 3 : Të ardhurat për ha sipas sistemeve të menaxhimit të ullishteve



Edhe në terma finanzia vrehet i njëjti trend i rezultateve sipas sistemeve. Janë dukshëm më rezultativ dy sistemet e para në krahasim me të tretin.

Sipas këtyre fakteve duhet abandonuar mendimi fermer se me ullishtet margjinale nuk mund të arrihet efikasitet ekonomik, me gjithë shërbimet që kryhen. Në fakt, edhe sipas të dhënave që komentuar, ky efektivitet nuk mund të realizohet vetëm në rastin kur në këto ullishte nuk kryhen shërbimet e nevojshme agroteknike, kur

abandonohen ose nënvleftësohen edhe role të tjera të rëndësishme të këtyre ullishteve për brezat e ardhshëm, si pasuri e madhe agroturistike dhe mbrojtjen e terreneve ku ato shtrihen nga erozioni.

#### V. Konkluzione

Analizat e bëra tregojnë që të ardhurat që vijnë nga ullishtaria shpesh herë janë negative por është e mundur të arrihen dhe rezultate pozitive. Siç theksuam elementët që kompromentojnë prodhimin në këtë rast efienca ekonomike, cilësia e punës së përdorur, vecanërisht për shërbimet agroteknike. Me mos ndryshimin e këtyre kushteve, mund të afirmohet se ullishtaria mund të bëhet jetësore atje ku fermat investojnë dhe rinovojnë impiantet duke përdorur zgjidhje agronomike të përshtatshme për kushte të ndryshme ambjentale dhe struktura të ndryshme ferme. Në këtë kontekst dhe në mvarësi të ristrukturimit dhe rinovimit të impianteve, është e dëshërushme të procedohet edhe me përshtatje të mjeteve mekanike dhe agregateve përkatëse për kryerjen e operacioneve më të kushtushme (krasitja, vjelja, trajtimet antiparazitare), në fund për uljen e kostos për njësi të këtyre operacioneve dhe rritjen e të ardhurave. Duke pasur parasysh dimensionet e vogla të fermave të ullishtarisë, mund të gjënden zgjidhje ekonomike të vlefshme në përdorimin e mjeteve të reja mekanike dhe agregateve si psh. nëpërmjet strukturave të specializuara (të tretë).



## STUDIMI 2

**B. “Planifikimi dhe ndjekja e kostove të prodhimit në pentari”****I. Justifikimi i argumentit**

Kostot e prodhimit janë sot një faktor konkurues shumë i rëndësishëm në tregun e produkteve bujqësore. Kjo imponon një efikasitet më të madhe në të gjitha nivelet e prodhimit. Eficienca duhet të vlerësohet me orientimet që merr fermeri për të plotësuar kërkesat e konsumatorit me produkte me cilësi dhe shumëllojshmëri gjithnjë e më të lartë dhe vlera gjithnjë e më të arrira. Për të përballuar këtë fazë të re të merkatos, frutikulturët duhet të përmirësojnë potencialet prodhuese dhe të kontrollojnë apo të reduktojnë kostot e prodhimit sipas objektivave të përcaktuara. Sektori i frutikulturës duhet ketë objektive rritjen e standarteve në termat e efikasitetit për të cilën është themelore adaptimi i modeleve të reja të menaxhimit. Derisa kjo të bëhet e mundur është e nevojshme që kultivimi të lejojë shtim të resurseve që duhet të përdoren.

Kërkimi ka qëllimin specifik të evidentojë kostot e prodhimit. Prodhuesit duhet të modifikojnë orientimin e tyre të tregut duke shtuar prodhimin e produkteve me cilësi më të lartë edhe nëqoftëse ndryshimet janë të ngadalshme. Prandaj është e domosdoshme përcaktimi i origjinës dhe strukturës së kostos së prodhimit në kushte të ndryshme kultivimi, duke synuar që produkti të jetë ekonomikisht efikas në periudha të shkurtëra apo të gjata. Ky kërkim do të ishte, për komunitetin shkencor dhe profesional të frutikulturës, një burim informacioni i mjaftueshëm mbi kostot e një prodhimi të caktuar, në kushte specifike, i dobishëm për t’u orientuar drejt kërkimeve më të thelluara në këtë fushë.

**II. Qëllimi i kërkimit :** Të sigurojë të dhëna bazë në terma të përdorimit të burimeve të ndryshme dhe të rezultateve ekonomike e produktive për të karakterizuar modele tekniko-ekonomike për ristrukturime në pentari, ullishtari e vreshtari.

**III. Materiali dhe metoda**

Kosto e prodhimit është e ndryshme sipas kushteve të kultivimit dhe objektivave cilësor të përcaktuar. Supozuar që kushtet e terrenit influencojnë koston e kultivimit, ndjekja e objektivave cilësor, gjithnjë në rritje, imponon zgjedhje menaxhimi të ndryshme dhe me impakt të fortë mbi këto kosto. Për këtë motiv studimi nuk është bërë në përgjithësi por i është referuar rasteve specifike, për rreth 100 ferma në 9-të qarqe të zonës së ulët dhe bregdetare.

Numuri jo i madh i fermave, së bashku me faktin që kampioni është zgjedhur në mënyrë ratësore përbën një kufizim në terma përfaqësimi, por kjo bilancohet nga vërtetësia e të dhënave të grumbulluara nga fermeri.

Rastet e analizuara përfshijnë kushte prodhimi të orientuara drejt menaxhimit të këtij sektori për kultivarë dhe nivele të ndryshme cilësie, të karakterizuar nga një potencial prodhimi, pak a shumë, i lartë dhe në kushte të ndryshme në terma të vlerave të terrenit dhe tokës.

Proceset prodhuese të studjuara janë identifikuar nëpërmjet skedave të plotësuara me fermerët në qarqe. Në këtë mënyrë është grumbulluar informacion mbi teknikat e përbashkëta të kultivimit të përshtatura në terrene të ndryshme. Mbi bazën e këtij informacioni, për çdo kulturë, është evidentuar një proces produktiv përfaqësues i përcaktuar në terma përzgjedhje të praktikave kulturore të përshtatura.

Analizat janë bërë për ferma frutikulture të specializuara dhe mikse të përmasave të ndryshme, të menaxhuara nga fermeri me punën direkte të familjarëve të tij apo dhe me të punësuar.

Kjo analizë ka lejuar të evidentojmë tregues të tipit cilësor që janë konsideruar të dobishëm për situata komplekse në brëndësi të realitetit të zonave.

Materiali burimor për kryerjen e analizës së kostove të prodhimit kanë qënë 105 intervista të kryera me fermerë në 9 qarqe të vendit : Vlorë, Fier, Berat, Durrës, Tiranë, Elbasan, Lezhë, Shkodër. Është tentuar që fermat e intervistuar të përfaqësojnë zonat ku shtrihen. Me anë të skedave është grumbulluar informacion për tre sektorë : pemtari, ullishtari dhe vreshtari. Në to është pasqyruar niveli ekonomik-financiar i fermës së pemtarisë dhe mbas përpunimit të të dhënave është konkluduar për disa tregues kryesor si : specializimi i prodhimit dhe epërsitë e tij, kostot dhe çmimet e produktit, të ardhurat për ha dhe të ardhurat neto për fermë etj.

Për përpunimin e treguesve është përdorur metodë e thjeshtë e analizës statistikore të të dhënave të marra nga skedat e plotsuara më parë.

#### IV. Rezultate dhe diskutime

Mbështetur në të dhënat e grumbulluara struktura e sipërfaqeve të mbjella për të gjitha qarqet paraqitet në tabelën e mëposhtëme :

Tabela 1: Struktura e sipërfaqeve të mbjella

speciet	ha	%
Agrume	3,31	0,9
Pemë	53,546	15,7
Vreshta	262,9	77,2
Ullishte	20,75	6,1
Totali	340,506	100

Sipas të dhënave prodhimi i rrushit është aktiviteti kryesor i fermerit, sepse në dekadën e parë të këtyre 20 viteve u zhvillua kryesisht vreshtaria për shkak të plotësimit të nevojave emergjente të familjes fermere për mbijetesë, kërkesë që e plotësonte ky sektor për karakteristikat e tij të garantimit të të ardhurave brënda një periudhe të shkurtër.

Si rezultat teknologjia e kultivimit është pothuajse e konsoliduar, pamvarësisht të problematikave që hasen.



Aktiviteti dytë më i rëndësishëm rezulton të jetë pemtaria.

Prandaj analiza është fokusuar, kryesisht në këtë sektor, meqëse është tentuar, të studjohen fermat intensive dhe superintensive, që në këtë rast, janë më të përhapura dhe duke i konsideruar këto sisteme menaxhimi si të ardhmen e zhvillimit eficient të frutikulturës dhe të konkurshmërisë produktit.

Tabela 2 : Sipërfaqet e mbjella me pentari

speciet	ha	%
Dardhë	5,7	10,6
Hurma	1,2	2,3
Pjeshkë	12,7	23,7
Mollë	28,7	53,7
Kumbull	2,9	5,4
Qershi	2,3	4,3
Totali	53,5	100

Referuar tabelës speciet më të kultivuara janë pjeshka dhe veçanërishtë molla me mbi 50 % të sipërfaqes së studjuar.

Meqëse kultura e mollës, krahasuar me speciet e tjera, krijon mundësi më të mëdha për aplikim të teknologjive më të përparuara të kultivimit, zë një peshë të konsiderushme në plotësimin e kërkesave të konsumatorit për frutat dhe është shtrirë tashmë gjërësishtë në zonën e ulët dhe bregdetare, në të cilën kemi kryer studimin, ne jemi përqëndruar, pikërishtë, në analizën ekonomiko-financiare të aktivitetit të prodhimit të këtij produkti.

Për këtë kemi analizuar të dhënat për 21 ferma me një sipërfaqe 28,73 ha ose 1,36 ha/fermë, nga të cilat 81 % janë të specializuara vetëm për prodhimin e mollës. Mbillet në një përqindje të konsiderushme të sipërfaqes pothuajse në të gjitha qarqet kultivari Golden dhe Starking. Disa prej kultivarëve kanë gjetur shtrirje më të gjërë në disa zona si : cv.Gala në qarkun e Durrësit dhe të Tiranës, cv.Pink Ledy në Fier dhe cv.Gran Smith në Elbasan.

Në 7,5 ha kjo kulturë menaxhohet si intensive me 911 bimë/ha dhe në 21,23 ha si superintensive me 2225 bimë/ha.

Tabela 3 : Rendimenti kg/rrënjë dhe kv/ha

kultivari	ha	kv	kv/ha	kg/rr
Gala	3,35	1104	330	14
Golden	12,1	3906	323	20
Pink Ledy	8,2	4396	536	23
Starking	2,8	744	266	19
Gran Smith	1,82	388	213	18
Fuji	0,46	228	496	25
Totali	28,73	10766	375	20

Nga e gjithë sipërfaqja është marrë rreth 375 kv/ha ose afërsishtë 20 kg/rr. Këta tregues janë disa herë më të lartë se tek pentoret e zakonshme\*, prandaj pentoret intensive dhe superintensive, qoftë dhe vetëm për sa më sipër, meritojnë vëmendjen e fermerit për zhvillimin e një pentarie rentabël, të qëndrueshme dhe konkurrese. Bie në sy, veçanërishtë, rendimenti i realizuar në sipërfaqet e mbjella me kultivarët : Fuji dhe Pink Ledy, të shtrira kryesishtë në qarqet : Fier, Vlorë dhe Tiranë, që për nga vlerat, cilësia, periudha e pjekjes dhe kërlesat e konsumatorit duhet të mbillen në sipërfaqe më të gjëra edhe në qarqet e tjera.

**Disa tregues financiar**

Në studim kanë përparësi kryesore, sepse nëpërmjet tyre kemi evidentuar efektivitetin e aktivitetit të fermerit në kultivimin e mollës. Elementët kryesor të këtyre treguesve janë kosto e prodhimit dhe çmimi i shitjes, të cilët, duhen kontrolluar dhe ndjekur me përgjegjësi për t'u orientuar për ushtrimin ose jo të këtij aktiviteti.


Tabela 4 : Shpenzimet per ha dhe kv

kultivarët	ha	000 leke	Lekë/ha	kv	Lekë/kv	Kv/ha
Gala	3,35	1032	308	1104	0,9	330
Golden	12,1	4629	383	3906	1,2	323
Pink Ledy	8,2	1845	225	4396	0,4	536
Starking	2,8	792	283	744	1,1	266
Gran Smith	1,82	583	320	388	1,5	213
Fuji	0,46	316	687	228	1,4	495
<b>Totali</b>	<b>28,73</b>	<b>9197</b>	<b>320</b>	<b>10766</b>	<b>0,9</b>	<b>375</b>

Referuar të dhënave evidentohen qartë epërsitë e prodhimit intensiv. Në sipërfaqe më të mëdha dhe rendiment më të lartë shpenzimet për ha dhe kv janë më të ulta, krahasuar me sipërfaqe dhe rendiment më të ulët, ku ato rezultojnë më të larta.


\*Te dhënat krahasuese marrë nga studimi “Modele ekonomike të fermave të pemtarisë në rrethin e Vlorës”

Grafiku 1 : Shpenzime 000 lekë për ha



Edhe nga grafiku nr.1 del se në blloqe me mollë nën 1 ha shpenzimet për 1 ha janë afërsishtë 22 % më të larta se në sipërfaqe të mbjellë mbi 1 ha, ndërsa në pemtoret intensive ato janë 9 % më shumë se në pemtoret superintensive. Efijencë më e lartë shpenzimesh prodhimi rezultojnë tek pemtoret superintensive, krahasuar me ato intensive, edhe pse në përqindje të vogël. **Edhe një herë të dhënat orientojnë qartë fermerin për zgjedhjen që duhet të bëjë kur vendos për të mbjellë pemë frutore dhe kërkon që ajo të jetë fitimprurëse.**

Grafiku 2 : Struktura e shpenzimeve



Në pemtari, përgjithësisht, koston e prodhimit e rëndojnë shpenzimet materiale dhe në disa kultura si ulliri edhe puna e krahut, sepse niveli i mekanizimit është akoma i ulët (10-16 %)\*. Në rastin e menaxhimit intensiv të pemtores ka rënie të shpenzimeve të punës së krahut dhe rritje të nivelit të mekanizimit, krahasuar me pemtoret apo ullishtet e zakonshme të specializuara ose të përziera.



Ndikim në këtë drejtim ka dhe madhësia e sipërfaqes ku zbatohen teknologjitë. Në blloqe nën 1 ha ulet shkalla e mekanizimit afërsisht 10 %, në krahasim me blloqe mbi 1 ha, sikundër në pemtoret superintensive me 2225 rr/ha ka rritje të këtij niveli me rreth 4 % më shumë se tek pemtoret intensive. Në sipërfaqe ku shpenzimet për proceset e mekanizuara janë mbi 40 % ka ulje me rreth 8 % në totalin e tyre.

**Rezulton se rritja e shkallës së mekanizimit është faktor vendimtar për reduktimin e kostos së**

**prodhimit.**

#### **Disa tregues financiar**


Sistemet intensive dhe superintensive të menaxhimit të pemtoresve rezultojnë rentabël. Jo vetëm në rastin që kemi studjuar, por për të gjitha aktivitetet që zhvillon në fermë, fermeri duhet të jetë plotësisht i angazhuar që ato të dalin me fitim. Rezultatet e studimit duhet të shërbejnë si promotor

\*Të dhëna të marra nga studimi “Kosto e prodhimit për ullirin e tavolinës”

për zgjedhje aktivitetesh në të tilla kushte financiare, nëqoftëse dëshëron të ketë qëndrueshmëri dhe garanci në zhvillimin e fermës.

Treguesi bazë i rentabilitetit të prodhimit është e ardhura neto, që në rastin tonë shkon rreth 996000 lekë/ha. Nëpërmjet përpunimit të të dhënave kemi parë se të ardhurat ndryshojnë ndjeshëm në kushte të ndryshme prodhimi.

Grafiku 3 : Të ardhurat 000 lekë sipas madhësisë sipërfaqes dhe tipit të pemtores



Grafiku 4 : Të ardhurat 000 lekë/ha sipas nivelit të mekanizimit



Sipas grafikëve rritet efënca e prodhimit në sipërfaqe mbi 1 ha dhe sidomos në pentore mbi 1000 rr/ha shkon rreth 17 % më shumë se në pentore nën 1000 rr/ha. Kjo efëncë lidhet ndjeshëm dhe me shkallën e mekanizimit. Edhe pse konsiderohet se mekanizimi i proceseve të punës rrit koston për shkak të koston së lartë orare të punës, në fakt, sipas grafikut, kjo ndikon pozitivisht në uljen e koston totale dhe rritjen e të ardhurave për njësi të sipërfaqes.

Ashtu sikundër kemi theksuar dhe më sipër mekanizimi i proceseve të punës, ndikon pozitivisht jo vetëm për lehtësimin e punës së krahut por dhe në reduktimin e përdorimit të imputeve bujqësore. Kur shpenzimet me mekanikë zënë 26 % të totalit të tyre baza materiale zë 45 %, ndërsa kur të parat arrijnë 36 % të dytat ulen me rreth 4 %, një ulje që duket e vogël por, që, për sipërfaqe të gjëra, është shumë me interes për fermerin.

### Disa procese teknologjike

Grafiku 5 : Të ardhura 000 lekë/ha sipas mënyrave të ujitjes




Në këto tip fermash, që kemi studjuar, teknologjia e kultivimit është nga më të përparuarat. Por ne kemi analizuar mënyrat e ujitjes, si një element mjaft vendimtar për prodhime të këtyre niveleve.

Në 96 % të sipërfaqes bëhet vaditje me pika. Të ardhurat për ha janë afërsisht 30 % më të larta, krahasuar me metodën e ujitjes me rrjedhje, që kryhet, në përgjithësi në sipërfaqe të kufizuara dhe pentore të zakonshme.

Me prodhime të këtyre niveleve (mesatarisht 375 kv/ha), investimi për impiantin e vaditjes me pikë (që arrin afërsisht 400000 lekë/ha) është mjaft i dobishëm sepse shlyerja e investimit fillon që në vitin e tretë të jetëgjatësisë së këtyre pentoreve.

### Destinacioni i prodhimit

Grafiku 6 : Mënyrat e tregëtimit të prodhimit



Tregëtimi i prodhimit, në kushtet e vendit tonë, me mungesë të infrastrukturës, të enteve të legjitimuara dhe të paisura të grumbullimit, të garantimit të standarteve të marketingut dhe cilësisë dhe të mungesës së industrisë përpunuese, përbën problemin më të mprehtë për zhvillimin e qëndrueshëm të fermës

së pemtarisë. E kemi trajtuar këtë tregues për të evidentuar gjëndjen reale të tregëtimit të frutave dhe si rezultat për të identifikuar dhe një herë problematikat për këtë element të rëndësishëm të zinxirit të prodhimit.

Tregëtimi nga fermeri i rreth 83 % të prodhimit tek tregëtarët dhe veçanërisht tek tregtarët e shumicës është një fakt që shton garancitë e destinimit të prodhimit dhe nxit fermerët të vazhdojnë të investojnë për rritjen e sipërfaqeve të mbjella me pemtari intensive dhe superintensive si rruga më e sigurt për zhvillimin prespektiv të sektorit të pemtarisë, rritjen e nivelit të konkurrueshmërisë tij, plotësimin e kërkesave gjithnjë në rritje të konsumatorit dhe përballimin me sukses të konkurrencës në vend dhe jashtë tij.

**Mungesa totale e destinimit të prodhimit për përpunim industrial**, sa për mungesë të infrastrukturës përpunuese dhe për shkak të përballimit të konsumit, është një problem jo i vogël për fermerët por dhe për një zhvillim më të shpejtë të kulturave drufrutorë. **Gjykojmë se ky fakt duhet të vihet në qendër të vëmendjes së instancave politikbërëse për t'i dhënë një impuls zhvillimit të qëndrueshëm tëfrutikuturës, duke garantuar kështu thithjen e gjithë sasisë së prodhimit.**

### Konkluzione

Nga pikpamja ekonomike situata paraqitet e ndryshme sikundër demonstron nga analiza e bëra në studim. Për të garantuar fitimet e planifikuara të një kulture, që ka një strukturë të caktuar kostoje mjaft të qëndrueshme dhe që përballet me rritjen progresive të prodhimit, është e domosdoshme garancia e shitjes.

Për një të ardhme të sigurt duhet të përcaktohen objektiva të karakterizuara nga një konkurrencë tregëtare në rritje, për përballimin e të cilës do të ndihmonin krijimi i realiteteve të reja në sektorin e pemtarisë si këto që kemi analizuar në studim : **shtimi i sipërfaqeve të mbjella me pemtore intensive dhe superintensive.**

Për t'ju përgjigjur kësaj situatë duhet të planifikohet një kujdes në rritje për tregëtimin nëpërmjet reklamimit të produkteve të prodhuara në vende të reja konsumatore, duke synuar më parë arritjen e standarteve të duhura. **Veçanërisht të vendosur duhet të jemi në promovimin e produkteve autoktone.**

Rasti i studjuar tregon që në situatë të ndryshme kosto e prodhimit mund të reduktojë ritmet e mbjelljeve të reja, duke bërë që investimet fermeri t'i përqëndrojë për të rritur efektivitetin e tij, megjithëse strukturat aktuale të tregut si mungesa e kontratave të shitjes, parametrat cilësor korrektësisht në përdorim dhe niveli i raporteve në mes tregëtarëve dhe fermerit, nuk e lehtësojnë zhvillimin e prodhimit dhe tregëtimin e tij.

### **C. Bashkëpunimi me institucionet**

Ka një bashkëpunim efikas me USAID-AAC në bazë të një memorandumi me MBUMK, në fushën e transferimit të teknologjive. Janë kryer shumë trajnime dhe seminare, ku ndër më të rëndësishmit është Konferenca e Vajit të Ullirit në Maj 2013.

Kemi bashkëpunim me ESHF për testimin e kultivareve

Kemi realizuar një bashkëpunim efektiv me IBB në ullishtari, me prodhimin organik të ullirit, certifikimin në fushë dhe përpunim dhe nxjerrjen e produktit vaj organik nga parcelat tona. Parashikojmë që bashkëpunimi të shtrihet edhe në vreshtarinë me kultivarë autoktone.

Me CNR IVALSA, CRA- Romë, vazhdojmë të kemi shkëmbime teknike dhe transferim teknologjie për ullirin dhe pemët frutore si dhe shumëzimin e materialit bimor .

Me CPOV bashkëpunojmë për mbrojtjen e të drejtës së kultivarit

### **D. Projekte me institucione te huaja**

1..Projekti me MASH 2012-2014: “Aplikim në industrinë ushqimore i sistemeve sensoriale inovative për analizat e vajit të virgjër të ullirit që certifikojnë cilësinë, kontrollin dhe sigurinë ushqimore” IVALSA- Firenze, Itali.Kordinator Aulona Veizi

2 .RESGEN- “Ruajtja, karakterizimi, koleksionimi dhe përdorimi i resurseve gjenetike të ullirit” COI 2011-2013 Kordinator Dhimiter Panajoti

### **E. Bazat e teknologjive te komunikimit dhe informacionit**

Q T T B është përfshirë në një projekt UNJP/006/ALB/UNJ mbi forcimin e lidhjeve funksionale dhe ndertimi i kapacitetve midis aktoreve te kerkimit shkencor kombetar dhe sistemeve te ekstensionit per ti siguruar sherbime efektive fermereve ne te gjithe Shqiperine.

Q T T B Vlore brenda ketij rrjeti ka faqen e saj zyrtare ku gjenden informacione te karakterit teknologjik, inovacione dhe të reja shkencore në sektorin e pemtarise, vreshtarise ,ullirit dhe vajit te ullit e agrumeve.

Keto informacione mund të gjeni në adresën [ëëë.agro.al](http://ëëë.agro.al); [ëëë.mbumk.gov.al](http://ëëë.mbumk.gov.al)



**F. Menaxhuesit e projekteve**

Nr	Menaxhuesit	Funksioni	Kultura
1	Dhimiter Panajoti	Titullar Q T T B	Agronom Kultura e ullirit
2	Athina Llambro	Drejtores e Drejtorisë së Teknologjive	Agronome Peme frutore autoktone
3	Ipokrat Fiku	Pergjegjes i sektorit të Teknologjive	Agronom Hardhi (Pergjegjes projekti 1)
4	Lida Lazaj	Specialiste	Agronome Prodhimi i fidaneve (projekti 1)
5	Zaim Veshaj	Specialist Sektori i Teknologjive	Agronom Peme frutore (projekti 1)
6	Anesti Xhaxho	Personel teknik Sektori i Teknologjive	Agronom Kulturat dru frutore (projekti 1+2)
7	Adhurim Lazaj	Pergjegjes sektorit Menaxhimit te Resurseve gjenetike	Agronom Certifikimi i fidanëve te ullirit (projekti 2)
8	Aulona Veizi	Specialiste laboratorit	Kimiste Panel Test Vaji i ullirit (projekti 2)
9	Elektra Spahiu	Specialiste Laboratori	Biologe Analiza kimike (projekti 2)
10	Nikoleta Mone	Specialiste Laboratori kimik	Kimiste Analiza kimike (projekti 1+ 2)
11	Enver Braho	Pergjegjes sektori Analiza dhe modelimi i fermes	Agronom Analiza dhe Modelim Ferme (Pergjegjes projekti 3)
12	Lumturi Xhelilaj	Specialiste	Ekonomiste sektori Analize dhe Modelim Ferme (projekti 3)
13	Luljeta Malaj	Specialiste	Ekonomiste Analiza dhe Modelim Ferme (Projekti 3)
14	Ramo Merkohitaj	Specialist Pergjegjes sekt.	Agronom Baza Shamogjin
15	Mendim Baci	Specialist	Agronom Mbrojtje bimeve Baza Shamogjin